



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 468 Akti**

**Nr. 556 Vendimi**  
**Tiranë, më 26.7.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Pamela Qirko</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 22.7.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Shpëtim Garunja**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjo arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT PROCEDURALE**

1. Z. Shpëtim Garunja është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Z. Shpëtim Garunja, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 16.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Etleda Çiftja dhe Pamela Qirko.

3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 23.12.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia, të gjithë anëtarët të deklarojnë mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të fillojë hetimi administrativ i thellë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe, më pas, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

5. Në datën 13.1.2020, përmes postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit, mbi përbërjen e trupit gjykues dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Gjithashtu, Komisioni i kërkoi subjektit informacion shtesë, sipas pyetësorit standard.

6. Në përgjigje të tij<sup>2</sup>, subjekti paraqiti në Komision përgjigjet për pyetësorin standard dhe nuk ka deklaruar kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

7. Trupi gjykues, me vendimin e datës 8.7.2022, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të

<sup>1</sup>E-mail, datë 13.1.2020, ora 16: 52 “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

<sup>2</sup>Procesverbal mbi dokumentacionin e dorëzuar pranë Komisionit, datë 31.1.2020 (protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, në Komision).

paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

**8.** Në datën 8.7.2022, përmes postës elektronike<sup>3</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në këtë njoftim, subjektit iu kërkuua të paraqiste edhe shpjegime brenda datës 19.7.2022.

**9.** Në datën 19.7.2022, subjekti paraqiti pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, me anë të depozitimit në protokoll<sup>4</sup> pranë Komisionit.

**10.** Më tej, Komisioni, me anë të postës<sup>5</sup>, njoftoi subjektin e rivlerësimit se trupi gjykues vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 22.7.2022, në orën 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

**11.** Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**12.** Në datën 22.7.2022 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit, si edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë bashkë me avokatin K. S..

**13.** Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

**14.** Z. Shpëtim Garunja, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

---

<sup>3</sup>E-mail datë 8.7.2022, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit administrativ kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

<sup>4</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

<sup>5</sup>Ftesë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore publike për procesin tuaj të rivlerësimit", nr. \*\*\* prot., datë 20.7.2022.

15. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 22.7.2022, subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja kërkoi konfirmimin në detyrë.

16. Seanca dëgjimore e datës 22.7.2022 u ndërpre, për të rifilluar në datën 26.7.2022, me shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

17. Subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

19. Sipas krerëve IV, V dhe VI, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; dhe (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>6</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

##### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

21. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003

---

<sup>6</sup>Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

**22.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private për periudhën 2003 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting 2017*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar se: (1) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;* (2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;* (3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*(4) *nuk ka kryer deklarin të rremë;*(5) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**23.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, shpjegimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**24.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

#### **Pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

##### **1. Apartament banimi me sip. 86.5 m<sup>2</sup>, me vlerë 4.000.000 lekë, në Tiranë**

**1.1.** Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi, 2+1, me sipërfaqe ndërtimore 86.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, ap. \*\*\*, kati i \*\*\*, Tiranë, viti i krijimit 2001, me vlerë 4.000.000 lekë, nga të cilat 1.500.000 lekë kontrata e shitblerjes së apartamentit dhe 2.500.000 lekë vlera e investimit deri në momentin e parë të deklarimit. Pjesa takuese: 50% + 1/3 e 50% (trashëgimi ligjore). Si burim krijimi, subjekti deklaron: të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe bashkëshortes së deklaruesit dhe kredi nga

Enti i Kombëtar i Banesave. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>7</sup>.

**1.2.** ASHK-ja Tiranë<sup>8</sup> konfirmon se në pronësi të subjektit figuron i regjistruar apartamenti me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sipërfaqe 86.5 m<sup>2</sup>. Gjithashtu, referuar dokumenteve të origjinës së regjistrimit të kësaj prone<sup>9</sup> rezulton se sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 8.10.2001, me objekt “shitje, blerje apartamenti banimi në godinën 9-katëshe, të ndërtuar në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë”, subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., apartamentin me nr. \*\*\* (2+1), të ndodhur në katin e dytë, me sipërfaqe ndërtimi 86.5 m<sup>2</sup>. Kontrata parashikon se vlera e plotë e këtij apartamenti së bashku me çmimin e sipërfaqes së shkallëve dhe ashensorit është 1.500.000 lekë, kjo shumë është marrë tërësisht në dorë nga ana e shitësve dhe blerësi ka deklaruar se ka likuiduar plotësisht shitësit në masën 1.500.000 lekë jashtë zyrës noteriale.

**1.3.** Sipas vendimit “Për çeljen e trashëgimisë ligjore”, nr. \*\*\*, datë 16.1.2017, të administruar nga noter A. B.<sup>10</sup>, në datën 16.12.2016 ka ndërruar jetë shtetasja E. G. dhe trashëgimtarë ligjorë të saj janë përcaktuar: Shpëtim Garunja, bashkëshorti; S. G., e bija; Sh. G., e bija, të cilët trashëgojnë pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënëses me 1/3 pjesë secili.

**1.4.** Lidhur me ndryshimin midis vlerës së deklaruar të çmimit të blerjes së apartamentit (4.000.000 lekë) me atë e pasqyruar në kontratën e shitblerjes (1.500.000 lekë), në procesverbalin e datës 15.4.2016<sup>11</sup>, të ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar se: “... me vlerën 4.000.000 lekë të cilën unë e kam vendosur në deklaratën time kam dashur të shpreh vlerën e tregut të apartamentit pas blerjes dhe investimit të banesës ...”.

**1.5.** Me anë të pyetësorit nr. 1<sup>12</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues që provon pagesën e vlerës 1.500.000 lekë pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Në përgjigje<sup>13</sup>, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2022, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me anë të cilit kjo shoqëri vërteton se shtetasi Shpëtim Garunja ka shlyer pagesën kundrejt tyre, në vlerën 1.500.000 lekë, lidhur me apartamentin objekt i kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., datë 8.10.2001, me vendndodhje: kati dytë, ap. \*\*\*, pallati “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë. Gjithashtu, ka paraqitur dhe dokumente të tjera që provojnë pronësinë e tij lidhur me këtë apartament<sup>14</sup>.

---

<sup>7</sup>Kontratë shitjeje (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, datë 8.10.2001; mandatpagesë e Bankës së Kursimeve, datë 2.8.2001; mandatarkëtimi e Bankës së Kursimeve datë 2.8.2011; urdhër derdhje pranë Bankës së Kursimeve/Raiffeisen Bank, për periudhën gusht 2001 – janar 2017; vendim për çeljen e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*, datë 16.1.2017.

<sup>8</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2020.

<sup>9</sup>Paraqitur dhe nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

<sup>10</sup>Shkresë e datës 3.9.2021.

<sup>11</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2021, e ILDKPKI-së.

<sup>12</sup>E-mail datë 9.5.2022.

<sup>13</sup>E-mail datë 16.5.2022.

<sup>14</sup>Kopje të vërtetimit të pronësisë dhe kontratës së shitblerjes së apartamentit; kopje të kontratës me OSSHE-në nga shoqëria ndërtuese; kopje mandatarkëtimi, faturë e muajit dhjetor 2019, ku figuron edhe numri i kontratës me OSHEE-në, lidhur me banesën në pronësi time ndodhur në Tiranë, me nr. kontrate: \*\*\*, kopje libreze uji (UKT); kopje libreze OSHEE, për kontratën nr. \*\*\*.

**1.6.** Komisioni verifikoi të dhënat për tregun e lirë të apartamenteve për vitin 2001<sup>15</sup> në qytetin e Tiranës dhe rezultoi se çmimi ishte 56.306 lekë/m<sup>2</sup> dhe bazuar në këtë çmim, apartamenti i subjekti vlerësohet në shumën 4.870.469 lekë (56.306 x 86.5 = 4.870.469 lekë).

**1.7.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Çmimi i blerjes së apartamentit në shumën 1.500.000 lekë është shumë më i ulët se çmimi i tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2001, i përcaktuar në udhëzimin nr. \*\*\*, të Këshillit të Ministrave.*

**1.8.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>16</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se gjatë deklarimeve të tij, ndër vite, ka deklaruar gjithmonë vlerën e apartamentit pas blerjes dhe investimit në shumën 4.000.000 lekë. Më pas, shpjegon se godina ku ndodhet apartamenti është ndërtuar në vitet 1997-1999 dhe në atë periudhën nuk ka pasur çmime reference dhe pas kërkimeve për ofertën më të mirë në tregun e lirë është përcaktuar çmimi i blerjes me marrëveshjen e të dy palëve. Sipas tij, dokumentacioni i administruar nga ZVRPP dhe kontrata e shitblerjes e hartuar nga noteri përbëjnë provë të plotë në referim të neneve 11, 246, 260 dhe 261 të Kodit të Procedurës Civile, neneve 80 dhe 81 të Kodit të Procedurave Administrative, ligjit 110/2018, “Për noterinë”, si dhe neneve 45, pika 2, 49, pika 1, germa “b”, pika 4, 50, 53, 55 e vijues, të ligjit 84/2016.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.9.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**1.10.** Diferenca që ekziston midis çmimit të vendosur në kontratën e shitjes dhe me çmimin e çmimi i tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2001, i përcaktuar në udhëzimin nr. \*\*\*, të Këshillit të Ministrave, pavarësisht rrethanave të vënies së çmimit 1.500.000 lekë në kontratë, i cili është pa logjikë ekonomike për shitësin e apartamentit, por me interes për subjektin e rivlerësimit, nuk mund të përbëjë shkak për penalizimin e subjektit për atë kohë sa vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2003 dhe deklaratën e rivlerësimit se në total për këtë apartament ka shpenzuar shumën 4.000.000 lekë, shumë e cila është e përafërt me çmimin e shitjes së apartamentit në tregun e lirë sipas udhëzimit të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, në këtë vlerësim të Komisionit merret parasysh edhe fakti që subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe me ortakët e kësaj shoqërie gjatë ushtrimit të detyrës, gjë e cila mund të kishte ndikuar në vlerësimin nga ana e

<sup>15</sup>Udhëzim nr. \*\*\*, datë 31.5.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k”.

<sup>16</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

Komisionit, si një prej rrethanave të cilat mund të krijonin dyshime për kontratën e nënshkruar nga palët.

**1.11.** Sa më lart, Komisioni në analizë financiare për këtë pasuri, mori në konsideratë vlerën prej 4.000.000 lekë të deklaruar nga subjekti, nga të cilat 1.500.000 lekë të përcaktuar në kontratën e shitjes dhe 2.500.000 lekë të përdorura si investim për apartamentin.

**1.12. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka bërë deklarinimin sipas dokumentacionit që ai dispononte, pra, ka pasqyruar çmimin e paguar për blerjen e apartamentit në shumën 1.500.000 lekë, sipas kontratës së shitjes nr.\*\*\*, datë 8.10.2001; (i) subjekti i rivlerësimit ka investuar shumën 2.500.000 lekë në këtë pasuri; dhe (ii) deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me vlerën e apartamentit përputhet me dokumentacionin justifikues.

### **Burimet e krijimit**

**1.13.** Në deklaratën *Vetting 2017* subjekti ka deklaruar se vlera e apartamentit është në shumën 4.000.000 lekë, nga të cilat 1.500.000 lekë kontrata e shitblerjes dhe 2.500.000 lekë vlera e investimit deri në momentin e parë të deklarinimit. Si burim krijimi ka deklaruar pagën e tij dhe të bashkëshortes, si dhe kredi nga EKB-ja në shumën 2.258.000 lekë.

**1.14.** Në procesverbalin e datës 15.4.2016, të ILDKPKI-së, subjekti ka shpjeguar se nga kredia e marrë prej 2.258.000 lekësh, ka paguar shumën prej 1.500.000 lekësh për blerjen e apartamentit dhe pjesën e mbetur e ka përdorur për mobilimin e saj. Në pyetësorin standard<sup>17</sup>, subjekti ka deklaruar se mobilimi bazë, investimet e pajisjet elektrike kryesore të banesës, janë kryer nga momenti i blerjes dhe pas saj, periudha 2001-2003. Shuma e shpenzimeve të kryera, ka vijuar subjekti, është paraqitur në total prej tij, së bashku me vlerën e banesës, në deklaratën e parë periodike dhe në deklaratën *Vetting 2017*. Si pasojë, vlera e shumës së përafërt të gjithë shpenzimeve të kryera është rreth 1.700.000 lekë<sup>18</sup>.

**1.15.** Sa më sipër, Komisioni analizoi dy burimet e deklaruara për pagesën e shumës 4.000.000 lekë, konkretisht: (a) kredi në vlerën 2.258.000 lekë nga Enti Kombëtar i Banesave Lezhë; dhe (b) të ardhurat nga pagat e subjektit dhe bashkëshortes në vlerën 1.742.000 lekë<sup>19</sup>.

#### **a) Në lidhje me kredinë, në shumën 2.258.000 lekë, nga Enti Kombëtar i Banesave Lezhë**

**1.16.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB)<sup>20</sup> dhe nga Bashkia Lezhë<sup>21</sup> rezulton se ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Lezhë, në cilësinë e shitësit dhe shtetasit Shpëtim Garunja, në cilësinë e blerësit, është lidhur kontrata e shitjes me këste (kusht), nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, me objekt shitjen e një apartamenti banimi tip \*\*\*, me sipërfaqe ndërtimi 70 m<sup>2</sup>, që përbëhet nga (2+1), 70 m<sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi dhe 21.95 m<sup>2</sup> sipërfaqe në pjesën e përbashkët të shkallëve dhe pjesëve tjera të përbashkëta të pronës. Kontrata parashikon se vlera e apartamentit të blerë me fonde shtetërore është 2.258.000 lekë dhe vlera e apartamentit sipas çmimit të tregut të lirë është 3.500.000 lekë.

<sup>17</sup>Procesverbal mbi dokumentacioni e dorëzuar pranë Komisionit, datë 30.1.2020 (nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, në Komision).

<sup>18</sup>Subjekti ka deklaruar: "...Blerje të veçanta për shkak rinovimi të disa mobilieve e pajisjeve të caktuara të konsumuara a dëmtuara, si divane, televizor, lavatriçe dhe boljerët e tualetit dhe të kuzhinës, janë kryer në vitet e tjera. Datat e vitet e sakta të blerjes së këtyre të fundit dhe emrin e subjekteve ku janë blerë nuk e mbaj mend".

<sup>19</sup>Diferenca midis vlerës 4.000.000 me vlerën 2.258.000 lekë.

<sup>20</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2021.

<sup>21</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2021.



**1.17.** Lidhur me kushtet dhe mënyrat e pagesës, kontrata e mësipërme parashikon se për vlerën 2.258.000 lekë, blerësi do të paguajë interes 0.5% në vit, afati i shlyerjes së kredisë është 25 vjet dhe pagesa do të bëhet me këste mujore të barabarta në masën 7.827 lekë.

**1.18.** Kontrata ka parashikuar karakteristikat e pronës dhe përcakton se: “*1. Shitësi i shet blerësit një apartament banimi në bashkëpronësi të pandarë të ndodhur në katin III, shkalla nr. \*\*\*, banesa nr. \*\*\*, lagja “\*\*\*, Lezhë”*, me kufizimet përkatëse. Gjithashtu, kontrata ka përcaktuar se: “*Blerësi ka të qartë dhe është dakord që kjo kontratë nuk ndryshon të drejtën e përdorimit ose të zotërimit të pronës gjatë kohës së shitjes, si dhe kalimin e kredisë për objekt tjetër (ndërrimin e objektit mbi të cilin i është njohur e drejta e kredisë duke i kaluar kjo e drejtë për një objekt tjetër)...*”. EKB-ja ka përcjellë dhe dokumentacionin përkatës<sup>22</sup>.

**1.19.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting 2017* (të administruar dhe nga EKB<sup>23</sup>) rezulton se sipas mandatpagesës me nr. \*\*\*, datë 2.8.2001, figuron se marrës i shumës 2.257.000 lekë është shtetasi N. Ll., me përshkrimin “*sa paguar çeku nr. \*\*\*, datë 1.8.2001*”.

**1.20.** Në kushtet kur subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë<sup>24</sup> kredinë e marrë nga EKB-ja, Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>25</sup>, i kërkoi subjektit të shpjegonte, nëse kontrata e shitjes me këste, me kusht, nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, e lidhur me EKB-në Lezhë ishte zgjidhur, të paraqiste dokumentacionin ligjor përkatës, si dhe të shpjegonte lidhjen me shtetasin N. Ll.

**1.21.** Në përgjigje<sup>26</sup>, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti i mësipërm nuk është në pronësi dhe nuk është përdorur nga ana e tij. Kontrata e mësipërme, sqaron subjekti, është formale dhe vjen si rrjedhojë e trajtimit të familjes së tij si i pastrehë bazuar ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”. Në vijim, sqaron se nga ky apartament ka hequr dorë me dakordësinë dhe të përfaqësuesit të EKB-së Lezhë, të ndjerit Z. N., për shkak të transferimeve të vazhdueshme të tij nga njeri rreth në tjetrin dhe nga fakti se bashkëshortja e tij në atë periudhë vazhdonte të ishte me punë në Shkodër dhe fëmijët e tij të mitur ishin njëri në kopsht dhe tjetri në shkollë në Shkodër. Gjithashtu, sqaron se në këmbim të mos marrjes në përdorim të apartamentit që përmendet në kontratë, pas kryerjes së pagesës së menjëhershme ndaj EKB-së, me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 2.8.2001, në shumën 90.420 (nëntëdhjetë mijë e katërqind e njëzet) lekë, i është vënë në dispozicion shuma prej 2.257.000 lekësh, që është shuma që i detyrohet EKB-së. Për vërtetimin e deklarimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>27</sup>.

<sup>22</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2001, e Bashkisë Lezhë me anë të së cilës i është drejtuar EKB-së për dhënien e një kredie për blerje apartamenti familjes së subjektit pasi ishte i pajisur me statusin “i pa strehë”, prej katër vitesh; certifikata e përbërjes familjare e subjektit me 4 vetë (ku nuk dallohet se cila zyrë e gjendjes civile e ka lëshuar); vërtetimi i datës 15.1.2001, i EKB-së Lezhë (me shkrim dore) që vërteton se: “..... çmimi i shitblerjes së apartamenteve në qytetin e Lezhës është 50.000 lekë/m<sup>2</sup> ose për apartamentin me strukturën (2+1) dy dhoma e një kuzhinë çmimi është 4.000.000 lekë”; vërtetimi i Prokurorisë Lezhë, lidhur me pagën e subjektit dhe vërtetimi i Prokurorisë së Apelit Shkodër lidhur me pagën e bashkëshortes së tij; vërtetimi i Bankës së Kursimeve që vërteton se subjekti nuk ka detyrime; vërtetimi i Zyrës së Përmbarimit Lezhë që vërteton se subjekti nuk është debitor; dhe vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Lezhë që vërteton se subjekti nuk ka proces gjyqësor pranë saj.

<sup>23</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022.

<sup>24</sup>Me kontratën së shitjes nr. \*\*\*, datë 8.10.2001.

<sup>25</sup>E-mail datë 9.5.2022.

<sup>26</sup>E-mail datë 16.5.2022.

<sup>27</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.3.2000, e Ministrisë së Financave-Tiranë; tri kërkesa për informacion drejtuar ASHK-së Lezhë, UKT-Lezhë, OSHEE-Lezhë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, të ASHK-së Lezhë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2022 e

**1.22.** Komisioni iu drejtua sërish EKB-së, e cila në përgjigje<sup>28</sup> informoi se: (i) EKB-ja ka blerë nga shtetasi N. Ll. apartamentin me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup> me adresë lagja “\*\*\*\*”, kati \*\*\*, shkalla nr. \*\*\*, banesa nr. \*\*\*, Lezhë, me kontratë nr. \*\*\*, datë 1.8.2001<sup>29</sup>. Mandatpagesa me nr. \*\*\*, datë 2.8.2001, e Bankës së Kursimeve verifikon transaksionin për blerjen e apartamentit në shumën 2.257.000 lekë dhe, si pasojë, ky apartament ka kaluar në pronësi të EKB-së<sup>30</sup>; (ii) EKB-ja, në zbatim të legjislacionit përkatës, pasi ka blerë apartamentin nga N. Ll., ia ka shitur shtetasit Shpëtim Garunja; (iii) kontrata e lidhur me shtetasin Shpëtim Garunja është ende aktive dhe ky shtetas paguan pagesat e kësteve duke qenë zotërues i këtij apartamenti dhe jo pronar i ligjshëm i saj. Bashkëlidhur, EKB-ja ka paraqitur dhe dokumentacionin përkatës.

**1.23.** Nga verifikimi në sistemin elektronik të ASHK-së, rezulton se apartamenti i sipërcituar është privatizuar në datën 27.5.1993 nga shtetasi N. e L. Ll. dhe se aktualisht është ende në pronësi të tyre (dhe jo të EKB-së). Ky apartament është i regjistruar me nr. pasurie \*\*\*, z. k.\*\*\*, me sipërfaqe 55.82 m<sup>2</sup>, me adresë Bashkia Lezhë. Gjithashtu, rezulton se shtetasi N. Ll. pas lidhjes së kontratës së shitjes me EKB-në, në datë 18.2.2002 ka aplikuar pranë ZVRPP-së Lezhë për regjistrimin e kontratës së hipotekimit të nr. \*\*\*, datë 16.2.2002, në favor të “\*\*\*\*” sh. a., për garantimin e kredisë në shumën 300.000 lekë, duke vendosur në hipotekë apartamentin e mësipërm<sup>31</sup>. Më pas, rezulton se shtetasi N. Ll. në datë 9.3.2010, ka aplikuar në ZVRPP-në Lezhë për fshirjen e hipotekimit, duke paraqitur deklaratën noteriale nr.\*\*\*, datë 5.3.2010, ku “\*\*\*\*” sh. a. ka deklaruar se ky shtetas ka shlyer kredinë e marrë. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin elektronik të ASHK-së të pasurive në pronësi të EKB-së, aktualisht nuk figuron asnjë pasuri në emër të EKB-së Lezhë në objektin (pallatin) me numër pasurie\*\*\*, z. k. \*\*\*, Lezhë.

**1.24.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *(i) deklarimi i subjektit në deklaratën Vetting, se burimi i krijimit të pasurisë apartament në Tiranë është kredia nga EKB në shumën 2.258.000 lekë, nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues dhe, për pasojë, duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë (1.500.000 lekë) dhe investimin në të (758.000 lekë); (ii) në kushtet kur EKB-ja e konsideron në fuqi kontratën me subjektin e rivlerësimit, duket se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting pasurinë apartament nr. \*\*\*, të tipit 2+1, kati \*\*\*, hyrja \*\*\*, me adresë rruga “\*\*\*\*”, Lezhë, sikurse parashikohet në shtojcën 2, të ligjit nr. 84/2016.*

---

FSHU-së; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, të UK-së, Lezhë; kopje mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 2.8.2001; kopje mandatpagese nr. \*\*\*, datë 2.8.2001; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2010, të EKB-së Lezhë; certifikatë vdekje, datë 10.5.2022, e Zyrës së Gjendjes Civile Lezhë, për të ndjerin Z. N., ish -drejtues i EKB-së Lezhë; mandatpagesa të kryera për llogari të EKB-së.

<sup>28</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022.

<sup>29</sup>Referuar kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, rezulton se shitësit, N. dhe L. Ll. i kanë shitur blerësit, Entit të Banesave, dega Lezhë, banesën nr. \*\*\*, e cila ndodhet në qytetin e Lezhës në lagjen “\*\*\*\*”, kati i tretë, e përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë me aneks, kundrejt shumës 2.258.000 lekë. Sipas mandatpagesës nr. \*\*\*, datë 2.8.2001, të Bankës së Kursimeve, shtetasi N. Ll. ka tërhequr shumën 2.258.000 lekë.

<sup>30</sup>Bashkëlidhur ka përcjellë kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* dhe mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 2.8.2001, të Bankës së Kursimeve.

<sup>31</sup>Apartmentin nr. \*\*\*, i cila ndodhet në qytetin e Lezhës, kati i tretë i përbërë nga një dhomë, një kuzhinë dhe aneks.

**1.25.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>32</sup>, subjekti shpjegon se apartamenti i pasqyruar në kontratën nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, nuk është në pronësinë e tij dhe nuk është përdorur asnjëherë prej tij dhe kontrata e mësipërme është formale. Në vijim, subjekti sqaron se nga ky apartament ka hequr dorë me dakordësinë e përfaqësuesit të EKB-së Lezhë. Shuma në vlerën 2.257.000 lekë, deklaroi subjekti, i është dorëzuar personalisht bashkë me mandatpagesën nr. \*\*\*, datë 2.8.2001, nga përfaqësuesi i EKB-së, z. Z. N. Gjithashtu, shpjegon se ka paraqitur dokumentacionin justifikues që provon se nuk e ka disponuar asnjëherë apartamentin në qytetin e Lezhës<sup>33</sup>.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**1.26.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**1.27.** Për të dalë në një konkluzion të drejtë, fillimisht duhen analizuar natyra e kontratës së shitjes me këste (kusht), nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, e lidhur ndërmjet EKB-së, dega Lezhë dhe subjektit të rivlerësimit, pasojat juridike të saj dhe, më pas, vërtetësia e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit se burim për blerjen e apartamentit në Tiranë është shuma 2.258.000 lekë nga EKB-ja.

**1.28.** Nga analizimi i përmbajtjes së kontratës nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, rezulton se kjo është një kontratë shitje me rezervë në kuptim të nenit 746<sup>34</sup> e vijues të Kodit Civil dhe përbën një veprim juridik me natyrë të dyfishtë. Nga njëra anë është veprim juridik detyrimi, por nga ana tjetër ka edhe një natyrë juridike pronësie.

**1.29.** Lidhur me ekzistencën e marrëdhënies së detyrimit (kredisë) ndërmjet EKB-së Lezhë dhe subjektit të rivlerësimit në shumën 2.258.000 lekë, nga hetimi administrativ, rezulton se: (i) ndërmjet EKB-së Lezhë, në cilësinë e shitësit dhe subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, në cilësinë e blerësit, është lidhur kontrata e shitjes me këste, me kusht, nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, me objekt shitjen me kusht të apartamentit të ndodhur katin \*\*\*, shkalla \*\*\*, banesa \*\*\*, e përbërë nga 2+1 me sip. 70 m<sup>2</sup>. Në këtë kontratë pasqyrohet se EKB-ja e ka blerë apartamentin me fonde shtetërore kundrejt shumës 2.258.000 lekë dhe se blerësi detyrohet të shlyejë detyrimin prej 2.258.000 lekë duke bërë pagesën me këste ku afati i shlyerjes është përcaktuar 25 vjet; (ii) në dosjen e privatizimit të apartamentit konstatohet pasqyra e amortizimit të kredisë në shumën 2.258.000 lekë; (iii) EKB-ja<sup>35</sup> konfirmon se subjekti shlyen pagesat e kësteve sipas planit të pagesave dhe se detyrimi i mbetur deri në përfundimin e kontratës është në vlerën

---

<sup>32</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision)

<sup>33</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, e ASHK-së Lezhë; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, UK Lezhë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2022, e FSHU-së; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, i FSHU-së.

<sup>34</sup>Kodi Civil, neni 746: “Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e kështit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë”.

<sup>35</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022.

281.266 lekë; (iv) subjekti ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit nr. 1, urdhërpagesat e likuidimit të kësteve në favor të EKB-së Lezhë.

**1.30.** Sa më sipër, evidentohet qartësisht dhe provohet se ndërmjet EKB-së Lezhë dhe subjektit të rivlerësimit ekziston një marrëdhënie detyrimi që ka lindur nga Kontrata e shitjes me këste, me kusht, nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, ku subjekti i rivlerësimit detyrohet t'i kthejë EKB-së shumën 2.258.000 lekë, si dhe ekzekutimi i detyrimit, i vërtetuar me deklaratimet e subjektit në deklaratat periodike vjetore dhe transfertat bankare nga llogaria e tij në llogarinë e EKB-së.

**1.31.** Lidhur me kalimin e të drejtës së pronësisë të apartamenti në Lezhë, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit rezulton se EKB-ja<sup>36</sup> sqaron se ka blerë nga shtetasit N. Ll. apartamentin me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, me adresë lagja “\*\*\*\*”, kati \*\*\*, shkalla nr. \*\*\*, banesa nr. \*\*\*, Lezhë, me kontratën nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, në shumën 2.257.000 lekë, transaksion që vërtetohet nga mandatpagesa e Bankës së Kursimeve me nr. \*\*\*, datë 2.8.2001. Në vijim, sqaron se në zbatim të VKM-së nr. \*\*\*, datë 2.6.2000<sup>37</sup>, pasi e ka blerë nga shtetasi N. Ll., sipas kontratës ia ka shitur këtë apartament shtetasit Shpëtim Garunja.

**1.32.** Ndërkohë që, Komisioni, duke analizuar dokumentacionin e administruar, deklaratimet e subjektit, por dhe situatën faktike të ndodhur, konstaton se pavarësisht se ka një kontratë shitje midis EKB-së si shitës dhe subjekti i rivlerësimit si blerës për këtë apartament, nga hetimi rezulton se subjekti nuk ka marrë apartament në dorëzim nga ana e EKB-së, pasi apartamenti objekt i kontratës nuk ekziston. Subjekti i rivlerësimit nga kjo marrëveshje ka përfituar vetëm shumën prej 2.257.000 lekësh, me të cilën ka paguar këstin e apartamentit të blerë në Tiranë. Komisioni arrin në këtë përfundim pasi: (i) objekti i kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, të lidhur ndërmjet shtetasve N. e L. Ll., me EKB-në, dega Lezhë është i ndryshëm nga objekti i kontratës së shitjes me këste, me kusht, nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe EKB-së Lezhë<sup>38</sup>, pavarësisht se janë lidhur në të njëjtën datë dhe në të njëjtin noter; (ii) subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1<sup>39</sup> dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>40</sup>, ka deklaruar se kontrata nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, me objekt blerjen e apartamentit në Lezhë, është formale dhe ka tërhequr vetëm shumën 2.258.000 lekë dhe këtë shumë ja ka dorëzuar dorazi ish-drejtuari i EKB-së Z. Nd.; (iii) kontrata e shitjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, e lidhur ndërmjet shtetasve N. e L. Ll. dhe EKB-së, dega Lezhë nuk është regjistruar në ASHK-së; (iv) shtetasi N. Ll. pas lidhjes së kontratës së shitjes me EKB-në ka vijuar të figurojë si pronar i apartamentit duke u sjellë si pronar me të drejta të plota, duke e vendosur në hipotekë për garantimin e shlyerjes së kredisë (shihni pg.1.23); (v) nga informacioni i administruar nga FSHU-ja<sup>41</sup> dhe shoqëria UK Lezhë<sup>42</sup>, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk figurojnë abonentë në qytetin e Lezhës. Pra, nga hetimi i Komisionit vërtetohet se ekziston marrëdhënia

<sup>36</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2022.

<sup>37</sup>“Për kriteret e blerjes dhe shitjes së apartamenteve nga Enti Komëtar i Banesave në tregun e lirë të banesave”.

<sup>38</sup>Në kontratën nr. \*\*\*, datë 1.2001, pasqyrohet se EKB-ja, dega Lezhë ka blerë nga shtetasit N. e L. Ll. apartamentin e përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë me aneks ndërsa në kontratën nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, përcaktohet se objekt i kontratës është shitja e një apartamenti të përbërë nga 2+1.

<sup>39</sup>E-mail datë 16.5.2022.

<sup>40</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

<sup>41</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020.

<sup>42</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022, i UK-së Lezhë (i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit).

e detyrimit midis subjektit si debitor dhe EKB-së si kreditore, por jo marrëdhënia e shitblerjes e pasurisë së paluajtshme apartament.

**1.33.** Krahas konstatimit të fakteve të mësipërme, Komisioni analizoi çështjen në kuptim të dispozitave ligjore në bazë të cilave është lidhur kontrata e shitjes me këste, me kusht, nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, si dhe të dispozitave ligjore që rregullojnë pasojat e veprimit juridik.

**1.34.** Referuar legjislacionit të kohës kur është lidhur kontrata nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, në fuqi ishte ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”, i ndryshuar (ligji nr. 8030/1995) që përcaktonte se çdo familje e pastrehë përfiton falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash sipas përcaktimeve të këtij ligji. Kjo shumë përfitimi përcaktohej nga numri i pjesëtarëve të familjes dhe mosha e tyre, si dhe kategoria e familjeve të pastreha e përcaktuar nga akte nënligjore<sup>43</sup>. Ligji parashikonte se qendër e banimit për familjet e pastreha për llogaritjen e përfitimit do të merret qendra ku ata kanë përfituar statusin si të pastrehë, ndërsa për ushtarakët dhe nëpunësit shtetërorë të transferuar, për llogaritjen e përfitimit, qendër e banuar do të merret ajo ku ata kanë përfitimin më të madh<sup>44</sup>.

**1.35.** Në rastin konkret, rezulton se në kohën e lidhjes së kontratës nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, subjekti i rivlerësimit ishte me banim në Shkodër<sup>45</sup> dhe vendin e punës e kishte në Lezhë. Sipas dokumentacionit të administruar<sup>46</sup>, rezulton se ka zgjedhur qytetin e Lezhës për marrjen e përfitimit si i pastrehë. Për shkak se ligji nr. 8030/1995, e kishte kushtëzuar përdorimin e kredisë me qendrën e banimit, subjekti i rivlerësimit nuk mund ta përdorte kredinë e marrë nga EKB-ja Lezhë për blerjen e apartamentit në një qytet tjetër. Nga hetimi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë apartament në Tiranë, duke deklaruar në deklaratën *Vetting 2017* dhe në deklaratimet periodike vjetore si burim krijimi të kësaj pasurie kredinë e marrë nga EKB Lezhë.

**1.36.** Nga hetimi administrativ është provuar se: (i) kontrata e shitjes nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, e lidhur ndërmjet shtetasve N. e L. Ll. dhe EKB-së Lezhë nuk është regjistruar në ASHK; (ii) shtetasi N. Ll. pas lidhjes së kontratës së shitjes me EKB-në ka vijuar të figurojë si pronar i apartamentit duke u sjellë si pronar me të drejta të plota pasi e ka vendosur në hipotekë për garantimin e shlyerjes së kredisë; (iii) objekti i kontratës së shitjes nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, është i ndryshëm nga objekti i kontratës së shitjes me këste, me kusht, nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, të lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe EKB-së Lezhë; (iv) subjekti i rivlerësimit pavarësisht se ishte me banim në Shkodër dhe vendin e punës e kishte në Lezhë ka blerë apartament në Tiranë duke deklaruar si burim të krijimit të kësaj pasurie shumën e marrë nga EKB-së Lezhë; (v) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kontrata nr.\*\*\*, datë 1.8.2001, me objekt blerjen e apartamentit në Lezhë, është formale dhe ka tërhequr vetëm shumën 2.258.000 lekë; (vi) nuk ka rezultuar që subjekti të jetë përdorues i ndonjë apartamenti në qytetin e Lezhës.

---

<sup>43</sup>Ligji nr. 8030/1995, neni 2 parashikon: “Çdo familje e pastrehë përfiton falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ky përfitim do të quhet shumë përfitimi. Shuma e përfitimit falas të çdo familjeje të pastrehë do të përcaktohet nga numri i pjesëtarëve të familjes dhe mosha e tyre, si dhe kategoria e familjeve të pastreha, e përcaktuar nga akte nënligjore...”.

<sup>44</sup>Ligji nr. 8030, neni 5 parashikon: “Qendër e banimit për familjet e pastreha për llogaritjen e përfitimit do të merret qendra ku ata kanë përfituar statusin si të pastrehë, sipas dispozitave ligjore, pavarësisht nga lëvizjet e mëvonshme të tyre. Për ushtarakët dhe nëpunësit shtetërorë të transferuar, për llogaritjen e përfitimit, qendër e banuar do të merret ajo ku ata kanë përfitimin më të madh”.

<sup>45</sup>Shkresë nr.\*\*\* prot., datë 13.12.2021, e DPGJC-së.

<sup>46</sup>Sipas dokumentacionit të administruar nga EKB-ja, Bashkia Lezhë e kishte të regjistruar si të pastrehë dhe kjo bashki i ka bërë kërkesë EKB-së për sistemimin e subjektit me banesë.

Në analizë të këtyre rrethanave dhe deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, Komisioni arrin në përfundimin se kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, si dhe kontrata e shitjes me këste, me kusht, nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, nuk kanë pasur si qëllim kalimin e pronësisë së apartamentit të ndodhur në Lezhë, por janë kryer me qëllim që subjekti i rivlerësimit të marrë shumën 2.258.000 lekë nga EKB-ja Lezhë. Për rrjedhojë, kontrata nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, e lidhur ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe EKB-së Lezhë nuk ka sjellë si pasojë lindjen e të drejtës së pronësisë së subjektit të rivlerësimit mbi apartamentin e ndodhur me adresë lagja “\*\*\*\*”, banesa nr. \*\*\*, kati \*\*\*, shkalla nr. \*\*\*, Lezhë, por vetëm marrëdhënien e detyrimit midis palëve. Kjo vërtetohet dhe nga deklarimi i subjektit, i cili pohon se ka hequr dorë nga marrja e pronësisë mbi apartamentin, por jo mbi detyrimin për pagimin e shumës së përfituar.

**1.37.** Lidhur me vërtetësinë e deklarimit të subjektit të rivlerësimit se burim për blerjen e apartamentit në Tiranë është shuma 2.258.000 lekë nga EKB, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktet se: (i) ndërmjet EKB-së Lezhë dhe subjektit të rivlerësimit ekziston një marrëdhënie detyrimi që ka lindur nga kontrata e shitjes me këste, me kusht, nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, ku subjekti i rivlerësimit detyrohet t’i kthejë EKB-së shumën 2.258.000 lekë; (ii) kontrata e mësipërme është një veprim juridik, i cili ka pasur për qëllim krijimin e marrëdhënies së detyrimit dhe jo të drejtën e kalimit të pronësisë së apartamentit; (iii) subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 dhe në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se ka tërhequr shumën 2.258.000 lekë dorazi ish-drejtuës i EKB-së Z. N.; dhe (iv) subjekti ka deklaruar se ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga pronësia e apartamentit, të gjitha këto prova dhe fakte të ndërlidhura me njëra tjetrën, krijoi bindjen se kredia e marrë nga EKB-ja Lezhë në shumën 2.258.000 lekë ka shërbyer si burim i krijimit të pasurisë së apartamentit me nr. Pasurie \*\*\*, z. k.\*\*\*, me sipërfaqe 86.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në rrugë “\*\*\*\*”, pall. “\*\*\*\*”, Tiranë. Si pasojë, Komisioni vlerëson ta marrë në konsideratë kredinë e EKB-së në shumën 2.258.000 lekë, duke e pasqyruar në analizën financiare.

**1.38. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting 2017* si burim për blerjen e apartamentit kredinë e marrë nga EKB është saktë në përputhje me ligjin; (ii) subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në shumën 1.500.000 lekë dhe kryerjen e investimit në të në shumën 758.000 lekë.

**b) Të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes, në vlerën 1.742.000 lekë (investimi në apartament)**

**1.39.** Referuar deklarimit të subjektit në pyetësorin standard, se ai ka filluar të banojë në këtë apartament që nga blerja e tij e në vijim<sup>47</sup>, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1993 – 2001, duke konsideruar: (i) të ardhurat nga paga të subjektit dhe bashkëshortes<sup>48</sup>; (ii)

<sup>47</sup>Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar: “[...] Gjatë kësaj periudhe, përpara blerjes së banesës tonë ku jetojmë dhe aktualisht kemi banuar përkohësisht në banesën e gjyshërve të ish bashkëshortes së ndjerë tek të ndjerët [...]”.

<sup>48</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (dy vërtetime me të njëjtin numër, si për subjektin ashtu edhe për të ndjerën bashkëshorten), Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër bën me dije se të ardhurat nga pagat janë përlogaritur referuar ligjit nr. 7668, datë 2.2.1993, ligjit nr. 7800, datë 2.3.1994, si edhe VKM-ve për vitet 1994-1997, për shkak se gjatë trazirave në vitet 1997-1998 institucioni i tyre është djegur dhe nuk disponohet dokumentacion përpara periudhës 15.2.1998; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; vërtetim njëhësi nr. \*\*\* rep., datë 20.1.2017, i shkresës nr.\*\*\* prot., datë 20.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Shkodër.

shpenzime jetike<sup>49</sup>; (iii) shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit; (iv) shpenzime për pagesë 4% dhe shlyerje për EKB; (v) investimin në apartament në vitin 2001, në vlerën 1.742.000 lekë, analizë e cila pasqyrohet në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 1993 – 2001, vetëm për burimin e dytë**

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Shpenzim	Gjendje progresive
1993-1999	Të ardhura nga paga subjekti	1,848,302	-	1,848,302
1993-1999	Të ardhura nga paga bashkëshortja	1,640,730	-	3,489,032
1993-1999	Shpenzime jetike	-	2,302,761	1,186,271
2000	Të ardhura nga paga subjekti	470,652	-	1,656,923
2000	Të ardhura nga paga bashkëshortja	272,846	-	1,929,769
2000	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	-	12,201	1,917,568
2000	Shpenzime jetike	-	432,000	1,485,568
2001	Të ardhura nga paga subjekti	510,850	-	1,996,418
2001	Të ardhura nga paga bashkëshortja	698,929	-	2,695,347
2001	Shpenzime jetike	-	432,000	2,263,347
2001	Shpenzime për pagesë 4% për EKB	-	90,420	2,172,927
2001	Shpenzime për shlyerje EKB viti 2001	-	41,600	2,131,327
2001	Shuma e investuar në apartament me burim pagat	-	1,742,000	389,327
	<b>TOTALI</b>	<b>5,442,309</b>	<b>5,011,382</b>	<b>389,327</b>

**1.40. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e investimit në vlerën 1.742.000 lekë, në apartamentin, në Tiranë.

## **2. Apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>, me vlerë 25.200 euro, në \*\*\*, Durrës**

**2.1** Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë porosie për ndërtim banese, ap.1x1, me sip. ndërtimore 56 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës, kati i 2-të, porositur në vitin 2006, çmimi 25.200 euro, shlyer deri në datën e deklarimit vlera 21.200 euro. Pjesa takuese: 50% + 1/3 e 50% (trashëgimi ligjore). Në seksionin “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë”, ka deklaruar “Detyrim ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., Tiranë për kontratë porosie (sipërmarrje), datë 20.11.2006, për ndërtim apartamenti 1x1, me sip. 56 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen \*\*\*, \*\*\*, Durrës, në shumën 4.000 euro”. Si burim krijimi deklaror të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>50</sup>. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting 2017* (të administruar nga noter V. S.<sup>51</sup>) rezulton se ndërmjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit dhe subjektit Shpëtim Garunja, në cilësinë e porositësit është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 20.11.2006, ku parashikohet se: “*Sipërmarrësi merr përsipër të ndërtojë apartamente banimi në godinën shumëkatëshe në Lagjen \*\*\*, \*\*\* Durrës dhe ti dorëzojë porositësit të përfunduar ambientin e banimit tip 9 me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup> që përbëhet nga një dhomë e një kuzhinë dhe ambiente ndihmëse, e ndodhur në katin e 2-të të banimit.....Sipërfaqet e përbashkëta janë të përfshira në sipërfaqen totale të*

<sup>49</sup>Të përlogaritura: (i) 66% e të ardhurave për periudhën 1993 – 1999; dhe (ii) bazuar në shkresën me nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së, për periudhën 2000 – 2016.

<sup>50</sup>Kontratë sipërmarrje nr. \*\*\*, datë 20.11.2006; mandatarkëtimi datë 20.11.2006, në shumën 8.200 euro; mandatarkëtimi, datë 21.2.2009, në shumën 10.000 euro; mandatarkëtimi, datë 12.10.2012, në shumën 3.000 euro.

<sup>51</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2021, në Komision.

*ambientit...". Gjithashtu, parashikohet se çmimi për ambientin e ndërtuar është në masën prej 25.200 euro dhe se pagesa do të bëhet nga porositësi për llogari të sipërmarrësit në 3 këste në këto afate: "(a) Në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate porositësi pagoi tek sipërmarrësi këstin e parë prej 8.200 euro, shumë të cilën pala sipërmarrëse e mori në dorë dhe nuk ka asnjë pretendim për këtë vlerë të likuiduar; (b) Këstin e dytë porositësi do ta paguajë me marrjen e çelësave në dorë, në masën prej 12.000 euro; (c) Kësti i tretë dhe i fundit prej 5.000 euro do likuidohet nga porositësi tek sipërmarrësi me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës sipas ligjit; (ç) çdo pagesë do të bëhet me para në dorë, me dokument të rregullt (mandatarkëtim) në euro...".*

**2.2.** Nga dokumentacioni i administruar nga shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k.<sup>52</sup> (të paraqitur dhe nga subjekti në deklaratën *Vetting 2017*), rezulton se: (i) sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 20.11.2006, kësti i parë, nga Shpëtim Garunja është arkëtuar shuma 8.200 euro më përshkrimin "*Blerjen e një apartamenti tip. 9 B, kati \*\*\* banimi, 56 m<sup>2</sup>*"; (ii) sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 21.2.09, nr. \*\*\*, kësti i dytë, nga Shpëtim Garunja është arkëtuar shuma 10.000 euro, me përshkrimin "*blerjen e një apartamenti 56.5 m<sup>2</sup>*"; (iii) dhe sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 12.10.2012, nr. \*\*\*, nga Shpëtim Garunja është arkëtuar shuma 3.000 euro, për "*likuidim ap.56.5 m<sup>2</sup>*". Shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k. konfirmon se vlera e likuiduar nga shtetasi Shpëtim Garunja deri në këtë datë (17.12.2021) është në shumën 21.200 euro dhe se mbetet detyrim i pashlyer në shumën 4.000 euro. Gjithashtu, sqaron se nuk është nënshkruar kontrata përfundimtare e shitblerjes së apartamentit dhe aktualisht apartamenti disponohet nga subjekti<sup>53</sup>.

**2.3.** Me anë të pyetësorit nr. 1<sup>54</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të deklaronte se kur e ka marrë në përdorim apartamentin. Në përgjigje<sup>55</sup>, subjekti ka deklaruar se nuk e ka marrë në përdorim dhe as e gëzon këtë apartament, pasi nuk është kryer akti i shitblerjes së apartamentit dhe as pagesa e plotë e apartamentit për shkak të mos përfundimit dhe kolaudimit të pallatit. Sipas tij, apartamenti aktualisht figuron në pronësi të subjektit ndërtues. Gjithashtu, ka deklaruar se nuk disponon kontrata të furnizimit me energji elektrike dhe ujë për këtë apartament për shkak të mos posedimit fizikisht. Për të provuar deklarin e tij, subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>56</sup>.

### ***Lidhur me pagesat e kryera për apartamentin në Durrës, sipas kësteve***

#### ***a) Kësti i parë në shumën 8.200 euro, në datën e lidhjes së kontratës më 20.11.2006***

**2.4.** Referuar dokumentacionit të administruar nga shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k.,<sup>57</sup> subjekti ka paguar vlerën 8.200 euro në datën 20.11.2006, çka përputhet me deklarin e tij në DIPP-në e vitit 2006 dhe me parashikimin në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 20.11.2006, ku përcaktohet se në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate porositësi pagoi te sipërmarrësi këstin e parë prej 8.200 euro, shumë të cilën pala sipërmarrëse e mori në dorë.

<sup>52</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2021.

<sup>53</sup>Nga përmbajtja e shkresës, termi "subjekt" i referohet subjektit tregtar dhe jo subjektit të rivlerësimit.

<sup>54</sup>E-mail datë 9.5.2022.

<sup>55</sup>E-mail datë 16.5.2022.

<sup>56</sup>Kontratë sipërmarrje datë 20.11.2006, lidhur me shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k.; 3 mandatarkëtime ( pagese) në favor të subjektit; 2 kërkesa për informacion drejtuar OSHEE dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës-Durrës.

<sup>57</sup>Me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.12.2021, është përcjellë mandatarkëtimi nr. \*\*\*, datë 20.11.2006.



**2.5.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 kontratën e sipërmarrjes dhe pagesën e kështit të parë në shumën 8.200 euro, si edhe ekuivalentin 1.020.080 lekë, me shënimin “pakësuar”. Për sa kohë subjekti ka deklaruar si burim krijimi pakësimin e likuiditeteve, Komisioni shqyrtoi deklaratimet, ndër vite, të subjektit lidhur me likuiditetet *cash* (trajtuar në pikën 6, të vendimit).

**2.6.** Bazuar në deklaratimet e subjektit, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2005, duket të ketë qenë në vlerën 1.240.000 lekë<sup>58</sup>. Më tej, për vitin 2006<sup>59</sup> ka deklaruar shtesë vlerën 1.120.000 lekë dhe pakësim vlerën 1.020.080 lekë<sup>60</sup>.

**2.7.** Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, për periudhën 2002-2003 (për kursimet në shumën 240.000 lekë) dhe për vitet 2004, 2005 dhe 2006, të pasqyruar në tabelën në vijim:

**Tabela nr. 2 – Analiza financiare për periudhën 2002 – 2003<sup>61</sup>**

Periudha	Përshkrim	Të ardhura	Shpenzim	Gjendje progressive
2002	Të ardhura nga paga subjekti	566,768		566,768
2002	Të ardhura nga paga bashkëshortja	816,094		1,382,862
2002	Shpenzime jetike		375,456	1,007,406
2002	Shpenzime udhëtimi vendbanim-vendi i punës		63,000	944,406
2002	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>		6,895	937,511
2002	Shpenzime për shlyerje EKB viti 2002		94,800	842,711
2003	Të ardhura nga paga subjekti	735,394		1,578,105
2003	Të ardhura nga paga bashkëshortja	973,283		2,551,388
2003	Shpenzime jetike		375,456	2,175,932
2003	Shpenzime udhëtimi vendbanim-vendi i punës		63,000	2,112,932
2003	Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>		13,365	2,099,567
2003	Shpenzime për shlyerje EKB viti 2003		94,800	2,004,767
2003	Gjendje likuiditete <i>cash</i> datë 31.12.2003		240,000	1,764,767
	<b>TOTALI</b>	<b>3,091,539</b>	<b>1,326,772</b>	<b>1,764,767</b>

**Tabela nr. 3 – Analiza financiare për vitet 2004, 2005 dhe 2006**

Përshkrim	2004	2005	2006
Shtim likuiditete cash	350,000	650,000	1,120,000
Pakësim likuiditete cash	0	0	-1,020,080
Shtim/pakësim likuiditete bankë	0	46,223	17,604
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>350,000</b>	<b>696,223</b>	<b>117,524</b>
Të ardhura nga pagat e subjektit	883,625	963,763	960,471

<sup>58</sup>Në deklaratën e parë të pasurisë viti 2003: *cash*, në shumën 240.000 lekë, të ardhura nga paga; në DIPP-në e vitit 2004: gjendje në *cash*, në shumën 350.000 lekë, 2004, kursime nga paga; në DIPP-në e vitit 2005: kursyer nga të ardhurat nga paga ime, e bashkëshortes, *cash* në shumën 650.000 lekë (kursime të përbashkëta me bashkëshorten).

<sup>59</sup>Në DIPP-në e vitit 2006: kursyer nga të ardhurat nga paga ime, e bashkëshortes, *cash* në shumën 1.120.000 lekë - shtuar (kursime të përbashkëta); paguar kësti I, 8.200 euro, vlera në lekë 1.020.080 lekë, pakësuar

<sup>60</sup>Në kushtet kur bashkëshortja e subjektit, E. G. ka qenë subjekt deklarues, Komisioni shqyrtoi dhe deklaratimet e saj lidhur me gjendjen *cash* në DIPP-të vjetore të viteve 2003 – 2006 dhe rezultoi se: në deklaratën e parë të vitit 2003 nuk ka deklaruar gjendje *cash*; në DIPP-në e vitit 2004 ka deklaruar shumën 350.000 lekë, me pjesë 50%, vitit 2004; në DIPP-në e vitit 2005 ka deklaruar “Kursime nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortit *cash* 650.000 lekë; në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar “Kursime nga pagat e deklarueses dhe bashkëshortit në shumën 1.120.000 lekë.

<sup>61</sup>Pa e përfshirë tepricën pozitive potenciale nga periudha e mëparshme.

Të ardhura nga pagat e të ndjerës/bashkëshortes	1,394,234	1,652,010	1,591,230
<b>Total të ardhura</b>	<b>2,277,859</b>	<b>2,615,773</b>	<b>2,551,701</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	375,456	438,228	438,228
Shpenzime shkollimi	0	0	70,000
Shpenzime udhëtimi vendbanim-vendi i punës	63,000	63,000	63,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	15,843	0	24,741
Shlyerje detyrimi për EKB Lezhë	87,000	86,900	94,900
Pagesë kësti i parë për apartamentin Durrës (8.200 euro)	0	0	1,020,080
<b>Total shpenzime</b>	<b>541,299</b>	<b>588,128</b>	<b>1,710,949</b>
<b>Balanca e fondeve (Të ardhura-ndryshim likuiditete-shpenzime)</b>	<b>1,386,561</b>	<b>1,331,422</b>	<b>723,228</b>

**2.8.** Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve *cash*, të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë në vlerën 8.200 euro, për apartamentin në Durrës.

**b) Kësti i dytë në shumën 10.000 euro, dt. 21.2.2009**

**2.9.** Referuar dokumentacionit të administruar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.,<sup>62</sup> subjekti ka paguar vlerën 10.000 euro në datë 21.2.2009, çka përputhet me deklarin e tij në DIPP-në e vitit 2009. Ndërkohë që, në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 20.11.2006, përcaktohet se këstin e dytë porositësi do ta paguajë me marrjen e çelësave në dorë, në masën prej 12.000 euro.

**2.10.** Në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e këstit të dytë në shumën 10.000 euro me burim kursimet e vitit 2008. Për sa kohë subjekti ka deklaruar si burim krijimi pakësimin e likuiditeteve, Komisioni shqyrtoi deklarinmet, ndër vite, të subjektit lidhur me likuiditetet *cash* (trajtuar në pikën 6, të vendimit).

**2.11.** Bazuar në deklarinmet e subjektit, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2008, duket të ketë qenë në vlerën 4.089.920 lekë<sup>63</sup>. Më tej, për vitin 2009 ka deklaruar shtesë vlerën 1.425.000 lekë dhe pakësim vlerën 10.000 euro<sup>64</sup>, në kushtet kur kursi zyrtar i këmbimit në datë 20.2.2009<sup>65</sup> ka qenë 1 euro = 130.29 lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë, në analizën financiare u pasqyrua vlera 1.302.900 lekë si ekuivalent i vlerës 10.000 euro.

**2.12.** Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2007-2008-2009, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të pasqyruar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 4 – Analiza financiare për vitet 2007, 2008 dhe 2009**

Përshkrim	2007	2008	2009
Shtim likuiditete <i>cash</i>	1,210,000	1,540,000	1,425,000
Pakësim likuiditete <i>cash</i>			-1,302,900
Shtim/pakësim likuiditete bankë	-131,829	57,575	10,800
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>1,078,171</b>	<b>1,597,575</b>	<b>132,900</b>

<sup>62</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2021, është përcjellë mandat arkëtimi nr. Serial \*\*\*, datë 21.2.2009.

<sup>63</sup>Në DIPP-në e vitit 2007: kursyer nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes, *cash* 1.210.000 lekë - shtuar (kursime të përbashkëta familjare); në DIPP-në e vitit 2008: kursyer nga të ardhurat e fituara nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, *cash* në shumën 1.540.000 lekë - shtuar (kursime të përbashkëta).

<sup>64</sup>Në DIPP-në e vitit 2009: kursyer nga të ardhurat e fituara nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, *cash* 1.425.000 lekë - shtuar (kursime të përbashkëta); te detyrimet financiare, ka deklaruar 10.000 euro shlyer me kursimet e vitit 2008.

<sup>65</sup>Për datën 21.2.2009 nuk ka informacion.

Të ardhura nga pagat e subjektit	981,452	990,655	1,098,926
Të ardhura nga pagat e të ndjerës/bashkëshortes	1,622,791	1,816,319	1,848,164
<b>Total të ardhura</b>	<b>2,604,243</b>	<b>2,806,974</b>	<b>2,947,090</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	696,288	546,480	546,480
Shpenzime për arredim	0	0	0
Shpenzime shkollimi	171,000	0	0
Shpenzime udhëtimi vendbanim-vendi i punës	63,000	63,000	63,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	12,091	284,552	324,407
Shlyerje detyrimi për EKB Lezhë	95,300	79,500	111,300
Pagesë kësti i dytë për apartamentin Durrës (10.000 euro)	0	0	1,302,900
<b>Total shpenzime</b>	<b>1,037,679</b>	<b>973,532</b>	<b>2,348,087</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura-ndryshim likuiditete-shpenzime)</b>	<b>488,393</b>	<b>235,868</b>	<b>466,103</b>

**2.13.** Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve *cash*, të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të dytë në vlerën 10.000 euro, për apartamentin në Durrës.

**c) Kësti i tretë në shumën 3.000 euro, në datën 12.10.2012**

**2.14.** Referuar dokumentacionit të administruar nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.,<sup>66</sup> subjekti ka paguar vlerën 3.000 euro në datën 12.10.2012, çka përputhet me deklarin e tij në DIPP-në e vitit 2012. Ndërkohë që në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 20.11.2006, përcaktohet se këstin e dytë porositësi do ta paguajë me marrjen e çelësave në dorë, në masën prej 12.000 euro, ndërsa kësti i tretë dhe i fundit prej 5.000 euro do likuidohet nga porositësi me kryerjen e aktit përfundimtar të shitblerjes së pronës sipas ligjit.

**2.15.** Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në shumën 3.000 euro, me kurs këmbimi 139.2 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash* për pagesën e këtij kësti dhe, për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare mori në konsideratë deklarin e subjektit në deklaratën *Vetting 2017* se burimi i krijimit kanë qenë të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe bashkëshortes.

**2.16.** Komisioni kreu analizën financiare në datën 12.10.2012 për të ardhurat, shpenzimet, pasuritë dhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

**Tabela nr. 5 - Analiza financiare, datë 12.10.2012**

<b>Përshkrim</b>	<b>12.10.2012</b>
Shtim likuiditete <i>cash</i> <sup>67</sup>	309,900
Shtim/pakësim likuiditete bankë	30,704
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>340,604</b>
Të ardhura nga pagat e subjektit <sup>68</sup>	866,709
Të ardhura nga pagat e të ndjerës/bashkëshortes <sup>69</sup>	1,457,193
<b>Total të ardhura</b>	<b>2,323,902</b>

<sup>66</sup>Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2021, është përcjellë mandatarkëtimi nr. Serial \*\*\*, datë 12.10.2012.

<sup>67</sup>Kursimet vjetore të deklaruara në vlerën 360.000 lekë, u përllogaritën në mënyrë përpjesëtimore për 10.33 muaj.

<sup>68</sup>Referuar kreditimeve në “Credins Bank”, për periudhën 1.1.2012 - 12.10.2012.

<sup>69</sup>Referuar kreditimeve në “Credins Bank”, për periudhën 1.1.2012 - 12.10.2012.

Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT <sup>70</sup>	485,593
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	6,986
Shlyerje detyrimi për EKB-në Lezhë	80,000
Pagesë kësti i tretë për apartamentin në Durrës (3.000 euro)	417,600
<b>Total shpenzime</b>	<b>990,179</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura-ndryshim likuiditete-shpenzime)</b>	<b>993,120</b>

**2.17.** Sa më sipër, Komision vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin për pagesën e këstit të tretë në vlerën 3.000 euro, për apartamentin në Durrës.

**2.18. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës 21.200 euro për blerjen e apartamentit në Durrës.

### **3. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me vlerë 7.000 euro**

**3.1.** Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti ka deklaruar automjet tip “Volkswagen, model Golf”, ngjyrë gri, targa \*\*\*, nr. Shasie \*\*\*, viti 2005, i regjistruar në pronësi të bashkëshortes dhe vajzës së deklaruesit, blerë datë 6.11.2013, me vlerë 7.000 euro nga të cilat 5.000 euro ose 695.713 lekë paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe pjesa tjetër në momentin e targimit të mjetit, Pjesa takuese: 1/3 e 50% (trashëgimi ligjore). Si burim krijimi deklararon të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>71</sup>.

**3.2.** Nga dokumentacioni i administruar nga DPSHTRR-ja<sup>72</sup>, paraqitur dhe nga subjekti në deklaratën *Vetting 2017*, rezulton se në aktin e shitjes të datës 6.11.2013, shtetasi I. T. deklaroi se i ka shitur znj. E. G. dhe znj. S. G. automjetin tip “Volkswagen”, me nr. Shasie \*\*\*, me çmimin 695.713 lekë, si dhe ka lëshuar faturën tatimore nr. \*\*\*, datë 6.11.2013, kundrejt blerësve E. G. dhe S. G., për shitjen e autoveurës, në vlerën 695.713 lekë.

**3.3.** Përpara ILDKPKI-së<sup>73</sup> subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin e datës 2.5.2016, të lëshuar nga shtetasi I. T., i cili vërteton se: “... në datën 6.11.2013 i ka shitur znj. E. G., automjetin tip ‘Volkswagen’ me nr. shasie \*\*\* për shumën 7.000 euro. Nga shuma e mësipërme, 5.000 euro ose 695.713 lekë i kam marrë në momentin e përpilimit të aktit të shitjes ndërsa pjesën tjetër të sasisë së lekëve më janë dhënë në momentin e nxjerrje së dokumentacionit dhe përpilimit të targave të mjetit”.

**3.4.** Komisioni konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting 2017*, lidhur me vlerën e autoveurës me targa \*\*\*, në shumën 7.000 euro, nuk përputhet me dokumentacionin justifikues, pasi sipas faturës tatimore nr. \*\*\*, datë 6.11.2013, të lëshuar nga

<sup>70</sup>Në mënyrë përpjesëtimore për 10.33 muaj.

<sup>71</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2016, nga DPSHTRR, Drejtoria Tiranë; leja e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me automjetin me targa \*\*\*, dosja e mjetit me targa \*\*\* e cila përmban: deklaratën e zhdoganimit datë 26.7.2013, nga I. T.;-fatura e blerjes së automjetit, në Gjermani, datë 15.7.2013, nga shtetasi I. T.; faturë tatimore shitje nr. \*\*\*, datë 6.11.2013, me palë shitëse I. T. dhe palë blerëse E. G. dhe S. G.; aktshitje datë 6.11.2013; vërtetim datë 2.5.2016, nga I. T. (fotokopje).

<sup>72</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020.

<sup>73</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 10.12.2021.

shtetasi I.T. dhe aktit të shitjes të datës 6.11.2013 vlera e shitjes së automjetit është në vlerën 695.713 lekë (5.000 euro).

**3.5.** Lidhur mundësitë e ligjshme financiare për blerjen e këtij automjeti, Komisioni konsideroi vlerën 7.000 euro, referuar deklarimeve të subjektit në deklaratën *Vetting 2017* dhe në DIPP-në e vitit 2013.

**3.6.** Për sa kohë subjekti ka deklaruar si burim krijimi pakësimin e likuiditeteve, Komisioni shqyrtoi deklaratimet, ndër vite, të subjektit lidhur me likuiditetet *cash* (*trajtuar në pikën 6, të vendimit*). Bazuar në deklaratimet e subjektit, gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2012, duket të ketë qenë në vlerën 6.332.198 lekë<sup>74</sup> dhe për vitin 2013 ka deklaruar shtesë vlerën 150.000 lekë<sup>75</sup>.

**3.7.** Sa më lart, Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2012 dhe 2013, për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të pasqyruar në tabelën në vijim.

**Tabela nr. 6 - Analiza financiare për vitet 2012 dhe 2013**

Përshkrim	2012	2013
Shtim likuiditete <i>cash</i>	350,000	150,000
Pakësim likuiditete <i>cash</i>		-980,700
Shtim/pakësim likuiditete bankë	9,628	11,236
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>359,628</b>	<b>-819,464</b>
Të ardhura nga pagat e subjektit	1,049,731	1,109,115
Të ardhura nga pagat e të ndjerës/bashkëshortes	1,836,788	1,705,838
<b>Total të ardhura</b>	<b>2,886,519</b>	<b>2,814,953</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	564,096	564,096
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	6,986	0
Shlyerje detyrimi për EKB-në Lezhë	96,000	164,000
Pagesë kësti i tretë për apartamentin Durrës (3.000 euro)	417,600	0
Pagesë blerje automjeti me targë *** (7.000 euro)	0	980,700
<b>Total shpenzime/pasuri</b>	<b>1,084,682</b>	<b>1,708,796</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura-ndryshim likuiditete-shpenzime)</b>	<b>1,442,209</b>	<b>1,925,621</b>

**3.8.** Nga analiza financiare, rezulton subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës 7.000 euro, për blerjen e automjetit, shtesën e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve.

**3.9.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhje me konstatimin se: *Deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2013, lidhur me vlerën e autoveturës me targa \*\*\*, nuk përputhet me dokumentacionin justifikues.*

**3.10.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>76</sup>, subjekti shpjegon se i qëndron deklarimeve të mëparshme të bërë në ILDKPKI se vlera e automjetit është 7.000 euro dhe ky fakt deklarohet dhe nga shitësi. Gjithashtu, shpjegon se ai nuk e ka firmosur kontratën e shitblerjes së mjetit

<sup>74</sup>Në DIPP-në e vitit 2012: kursyer nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, cash 350.000 lekë - shtuar

<sup>75</sup>Në DIPP-në e vitit 2013: kursyer nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, cash 150.000 lekë - shtuar.

<sup>76</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

dhe nuk ka qenë fizikisht në atë vend, por si blerës ka qenë ish-bashkëshortja e ndjerë bashkë me vajzën e tij S. dhe motra e ish-bashkëshortes.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**3.11.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**3.12.** Referuar nenit D<sup>77</sup>, të Aneksit të Kushtetutës, qëllimi i procesit të rivlerësimit është identifikimi i subjekteve të rivlerësimit që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohet ligjërisht. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit deklaroi se çmimi i blerjes së automjetit është i madh nga sa pasqyrohet në dokumentacionin justifikues dhe Komisioni ka pasqyruar në analizën financiare shumë të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting 2017*. Në këto kushte mospërputhja e deklaratimit të subjektit në deklaratën *Vetting 2017* me dokumentacionin justifikues nuk ndikon në procesin e rivlerësimit.

**3.13. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës 7.000 euro për blerjen e automjetit dhe nuk konstatojnë problematika të tjera për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

### **4. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Credins Bank”, në shumën 55.523 lekë**

**4.1.** Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti ka deklaruar gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Credins Bank”, në datë 20.1.2017, në vlerën 55.523 lekë me pjesë takuese 100%. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat nga paga e deklaruesit. Për vërtetimin e deklaratimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>78</sup>.

**4.2.** “Credins Bank”<sup>79</sup> konfirmon llogarinë dhe gjendjen e deklaruar nga subjekti.

**4.3.** Komisioni konstatojnë se kjo llogari është çelur në nëntor të vitit 2010 dhe kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat.

**4.4. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin, me burime financiare të ligjshme.

### **5. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në vlerën 875 lekë në “Raiffeisen Bank”**

**5.1.** Në deklaratën *Vetting 2017*, subjekti ka deklaruar gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 875 lekë. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat nga paga e deklaruesit. Për vërtetimin e deklaratimit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>80</sup>.

<sup>77</sup>Neni D: “1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më 64 të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur...”.

<sup>78</sup>Konfirmim nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2017, nga “Credins Bank”.

<sup>79</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2020.

<sup>80</sup>Nxjerrje llogarie në emër të Shpëtim Garunja pranë “Raiffeisen Bank”, për periudhën 29.3.2005 – 21.10.2016.

**5.2.** “Raiffeisen Bank”<sup>81</sup> konfirmon llogarinë dhe gjendjen e deklaruar nga subjekti<sup>82</sup>.

**5.3.** Komisioni konstaton se kjo llogari është çelur në prill të vitit 2005 dhe kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat.

**Në përfundim,** Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin, me burime financiare të ligjshme.

## **6. Gjendje cash në shumën 980.000 lekë**

**6.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar gjendjen *cash* në vlerën 980.000 lekë. Si burim krijimi deklaron të ardhurat nga paga, ndër vite, të tij dhe bashkëshortes.

**6.2.** Në procesverbalin e datës 15.4.2016 të ILDKPKI-së<sup>83</sup>, lidhur me kërkesën për të sqaruar gjendjen *cash* vit pas viti deri në datën 31.12.2014, subjekti ka deklaruar se: *“Për sa i përket gjendjes cash deklaroj se në banesë, në datën 31.12.2014, kam pasur gjendje 6.200.000 lekë. Nëse i referohemi deklaratave të mia ndër vite gjendja cash rezulton të jetë më e lartë, rreth 7.365.000 lekë, por kjo diferencë ka ndodhur sepse për nevoja familjare emergjente kursimet cash janë përdorur pjesë-pjesë ndër vite”*.

**6.3.** Duke u bazuar në deklaratimet e subjektit në DIPP-të vjetore, Komisioni pasqyroi në formë tabelare shtesat dhe pakësimet, duke i pasqyruar në analizën financiare të viteve respektive.

**Tabela nr. 7 - Analizë e ecurisë së gjendjes së kursimeve cash sipas DIPP-ve**

Viti	Deklaruar në DIPP	Shtesë	Pakësim	Progresive
2003	Gjendje <i>cash</i> , 240.000 lekë, të ardhura nga paga	240,000		240,000
2004	Gjendje <i>cash</i> , 350.000 lekë, viti 2004, kursime nga paga	350,000		590,000
2005	Kursyer nga të ardhurat nga paga ime, e bashkëshortes, <i>cash</i> 650.000 (kursime të përbashkëta me bashkëshorten)	650,000		1,240,000
2006	Kursyer nga të ardhurat nga paga ime, e bashkëshortes, <i>cash</i> 1.120.000 lekë – shtuar (kursime të përbashkëta)	1,120,000		2,360,000
2006	Paguar kësti I, 8.200 euro, vlera në lekë 1.020.080 lekë, pakësuar		-1,020,080	1,339,920
2007	Kursyer nga të ardhurat nga paga ime dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 1.210.000 lekë – shtuar (kursime të përbashkëta familjare)	1,210,000		2,549,920
2008	Kursyer nga të ardhurat e fituara nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 1.540.000 lekë – shtuar (kursime të përbashkëta )	1,540,000		4,089,920
2009	Kursyer nga të ardhurat e fituara nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 1.425.000 lekë – shtuar (kursime të përbashkëta)	1,425,000		5,514,920
2009	Te detyrimet financiare ka deklaruar 10.000 euro, shlyer me kursimet e vitit 2008		-1,302,900	4,212,020
2010	Kursyer nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 360.000 lekë – shtuar	360,000		4,572,020
2011	Kursyer nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 720.000 lekë – shtuar	720,000		5,292,020
2011	Tërhequr nga llogaria bankare (“Credins Bank”) dhe kaluar në gjendjen <i>cash</i> edhe shuma 680.178 lekë (vetëm DIPP-në e bashkëshortes)	680,178		5,972,198
2012	Kursyer nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 350.000 lekë – shtuar	350,000		6,322,198

<sup>81</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020.

<sup>82</sup>Referuar lëvizjes së llogarisë gjendja në datën 21.10.2016 ka qenë 975 lekë, vlera 875 lekë duket lapsus. Për periudhën 22.10.2016 – 18.4.2017, nga llogaria janë mbajtur vetëm komisione bankare.

<sup>83</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2021.

2013	Kursyer nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes, <i>cash</i> 150.000 lekë – shtuar	150,000		6,472,198
2013	Tek automjeti ka deklaruar “nga kursimet e përbashkëta të viteve të mëparshme të deklarimit”		-980,700	5,491,498
2014	Shtuar të ardhura nga VKM-ja nr. ***, datë 19.11.2014 për shpenzime mjekimi, vlera 3.000.000 lekë	3,000,000		8,491,498
2014	Pakësuar kursimet ndër vite të deklaruesit dhe bashkëshortes (për mjekim shëndetësor, gjendje <i>cash</i> 1.350.000 lekë)		-1,350,000	7,141,498
2015	Pakësuar kursimet ndër vite të deklaruesit dhe bashkëshortes (për mjekim shëndetësor, gjendje <i>cash</i> 850.000 lekë)		-850,000	6,291,498
2016	Pakësuar kursimet ndër vite të deklaruesit dhe bashkëshortes (kryesisht për mjekim shëndetësor të bashkëshortit të ndjerë e shërbime lidhur me të (4.370.000). Mbetur gjendje <i>cash</i> 980.000 lekë		-4,370,000	1,921,498

**6.4.** Komisioni, nga analiza financiare, konstaton se në deklaratën *Vetting* 2017 subjekti ka deklaruar gjendje 980.000 lekë, ndërkohë që referuar deklarimeve periodike vjetore, gjendja në fund të vitit 2016 rezulton në vlerën 1.921.498 lekë.

**6.5.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me konstatimin se: *Ka mospërputhje midis gjendjes së likuiditeteve cash të deklaruar në deklaratën Vetting 2017 (980.000 lekë) dhe asaj të përlllogaritur nga deklaratimet periodike vjetore (1.921.498 lekë).*

**6.6.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>84</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka deklaruar gjendjen reale *cash* që ka disponuar në atë moment.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**6.7.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**6.8.** Referuar germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003<sup>85</sup>, të ndryshuar, subjektet që mbartin detyrimin për deklarim detyrohen të deklarojnë vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Në vijim, referuar pikës 1, të nenit 7, të ligjit të mësipërm – “*Në deklarinin periodik jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat private [...]*” – detyrim që nuk është përmbushur plotësisht nga subjekti, për sa kohë që, sipas deklarimeve në DIPP-të vjetore, shuma e disponuar potencialisht nga ana e tij në momentin e hartimit të deklaratës *Vetting* 2017 duhej të ishte në vlerën 1.921.498 lekë, përkundrejt vlerës së deklaruar prej 980.000 lekësh.

<sup>84</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

<sup>85</sup>Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005; ligjin nr. 9475, datë 9.2.2006; ligjin nr. 9529, datë 11.5.2006; ligjin nr. 85/2012, datë 18.9.2012; dhe me ligjin nr. 45/2014, datë 24.4.2014.



**6.9.** Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, për çdo vit kalendarik. Po kështu, gjatë hetimit administrativ, nuk rezultoi asnjë e dhënë që subjekti i rivlerësimit ka përdorur gjendjen *cash* për të krijuar ndonjë pasuri, që do të duhej t'i nënshtrohej kontrollit nga Komisioni.

**6.10.** Sa më sipër, Komisioni, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>86</sup>, vlerëson se mospërputhja që vjen nga akumulimi potencial i shumave të deklaruara si *cash*, ndër vite, nga subjekti i rivlerësimit me deklarin e tij në momentin e përpilimit të deklaratës *Vetting* 2017, për sa kohë që nuk shoqërohet me mungesë të burimeve të ligjshme për të financuar të gjitha shpenzimet dhe pasuritë e krijuara në vite, nuk mund të konsiderohet se janë rrethana të mjaftueshme për të konkluduar se gjendet në situatat e parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku shkarkimi sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

**6.11. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 980.000 lekë.

## **7. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në shumën 3.210.538 lekë në “Credins Bank”**

**7.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes së ndjerë E. G. (B.), në vlerën 3.210.538 lekë, me pjesë takuese 1/3, nga trashëgimia ligjore. Si burim krijimi deklaron të ardhurat nga VKM-ja nr. \*\*\*, datë 13.7.2016 “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. E. B. (G.)”.

**7.2.** “Credins Bank”<sup>87</sup> konfirmon llogarinë dhe gjendjen e deklaruar nga subjekti.

**7.3.** Komisioni konstaton se kjo llogari është çelur në janar të vitit 2010 dhe kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat dhe transfertat nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm për mbulimin e shpenzimeve sipas VKM-ve përkatëse. Në vijim, Komisioni analizoi të ardhurat e përfituara nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm për mbulimin e shpenzimeve mjekësore.

**7.4.** Fillimisht, Komisioni vëren se këto të ardhura i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga ligji për t'u konsideruar si të ardhura të ligjshme, pasi në pikën 3, të nenit 8/1<sup>88</sup>, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikohet se shpërblimet e marra në raste sëmundjesh dhe fatkeqësish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi, janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.

**7.5.** Rezulton se me VKM-në nr. \*\*\*, datë 19.11.2014<sup>89</sup>, është vendosur mbulimi i shpenzimeve të mjekimit të znj. E. B., në shumën 3.200.000 lekë. Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të së ndjerës, u konstatua se në datën 12.12.2014 është transferuar shuma 3.091.974 lekë, me përshkrimin “*Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm sa pag. znj. E. G. (B.) mbulim shpenzime VKM nr. \*\*\*, datë 19.11*”. Më tej, në datën 29.12.2014 është tërhequr nga llogaria shuma 3.107.500 lekë.

<sup>86</sup>Vendim nr. 28-2020 (JR), datë 23.10.2020 dhe vendimi nr. 24-2021 (JR), datë 28.7.2021.

<sup>87</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.5.2022.

<sup>88</sup>Ligji nr. 8428/1998, neni 8/1: “Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale:....3. Shpërblimet e marra në raste sëmundjesh, fatkeqësish, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi...”.

<sup>89</sup>Botuar në fletoren zyrtare nr. \*\*\*, viti 2014.

**7.6.** Në vijim, rezulton se me VKM-në nr. \*\*\*, datë 13.7.2016, “Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. E. B. (G.)”<sup>90</sup> është vendosur mbulimi i shpenzimeve të mjekimit të znj. E. B. (G.), në shumën 3.300.000 lekë, duke parashikuar se pagesa do të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale, përkatëse, të institucionit të mjekimit. Nga shqyrtimi i llogarisë bankare të së ndjerës, u konstatua se Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm ka kryer dy transfertë, konkretisht, në datën 1.8.2016, me vlerë 2.942.800 lekë dhe në datën 7.9.2016, me vlerë 357.192 lekë, me përshkrimin “*likuidim për trajtim shëndetësor, sipas VKM-së nr. \*\*\*, datë 13.7.2016*”.

**7.7.** Më tej, vihet re që të ardhurat e përfituara nga VKM-ja në vitin 2016 kanë mbetur gjendje në llogarinë e të ndjerës deri në datën 9.5.2018<sup>91</sup>, datë në të cilën janë transferuar në llogarinë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së tij S. G., me përshkrimin “*kalim sipas vendimit të trashëgimisë nr. \*\*\*, datë 16.1.2017*”.

**7.8.** Lidhur me kohën dhe mënyrën e përdorimit të fondeve të përfituara me VKM, konstatohet se gjatë harkut kohor 1.4.2014 – 2.12.2014 është shpenzuar vlera 3.228.671 lekë për mjekimin e të ndjerës/bashkëshortes së subjektit. Këto shpenzime duket se janë përballuar me pakësimin e kursimeve (deklaruar pakësim në vlerën 1.350.000 lekë), kontributin vullnetar të shoqatës së prokurorëve dhe nga pagat.

**7.9.** Në datën 12.12.2014 janë përfitur në llogarinë e të ndjerës fondet e përfituara me VKM-në nr. \*\*\*, të cilat janë tërhequr në datën 29.12.2014 dhe janë deklaruar si likuiditete në DIPP-në e vitit 2014.

**7.10.** Gjatë periudhës 2015-2016 është shpenzuar vlera 5.748.654 lekë<sup>92</sup> për mjekimin e të ndjerës/bashkëshortes së subjektit. Këto shpenzime duket se janë përballuar me pakësimin e likuiditeteve *cash*, në total 5.220.000 lekë<sup>93</sup>. Në datat 1.8.2016 dhe 7.9.2016 janë përfitur në llogarinë e të ndjerës fondet e përfituara me VKM-në nr. \*\*\*, të cilat kanë qenë gjendje në llogarinë bankare në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* 2017 dhe, përfundimisht, më 9.5.2018 janë transferuar në llogarinë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe vajzës së tij S. G.

**7.11. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i saktë në përputhje me ligjin dhe me burime financiare të ligjshme.

## **8. Gjendje në llogarinë rrjedhëse në shumën 12.531 lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës S. G.**

**8.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje në llogarinë rrjedhëse në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të vajzës së deklaruesit, S. G., në shumën 12.531 lekë. Si burim krijimi deklaroi të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Për vërtetimin e deklarimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>94</sup>.

**8.2.** “Intesa Sanpaolo Bank”<sup>95</sup> konfirmon llogarinë dhe gjendjen e deklaruar nga vajza e subjektit.

<sup>90</sup>Botuar në fletoren zyrtare nr. \*\*\*, viti 2016.

<sup>91</sup>Vlera 3.200.538,38 lekë (të ardhura nga VKM dhe mbetje nga pagat).

<sup>92</sup>Respektivisht 1.748.654 lekë për vitin 2015 dhe 4.000.000 lekë për vitin 2016.

<sup>93</sup>Deklaruar 850.000 lekë pakësim në vitin 2015 dhe 4.370.000 lekë pakësim në vitin 2016.

<sup>94</sup>Nxjerrje e llogarisë, datë 23.1.2017, në emër të shtetases S. G., pranë “Intesa Sanpaolo Bank”.

<sup>95</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020.

**8.3.** Komisioni konstaton se kjo llogari është çelur në nëntor të vitit 2015 dhe kreditimet vijnë nga depozitime<sup>96</sup>, të kryera nga vajza e subjektit të rivlerësimit.

**8.4.** Në DIPP-në e vitit 2015, vajza e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit të lidhur, ka deklaruar llogari bankare nga të ardhurat e prindërve në “Intesa Sanpaolo Bank”, me vlerë 20.000 lekë dhe në DIPP-në e vitit 2016, ka deklaruar vlerën 12.531 lekë, mbetje gjendje në llogarinë bankare, me burim të ardhurat e prindërve.

**8.5. Në përfundim,** Komisioni nuk konstaton problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

## PASURITË E PERSONIT TË LIDHUR/ S. G.

### 9. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me vlerë 7.000 euro – gjendje në llogari në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 12.531 lekë

**9.1.** Këto pasuri janë analizuar në pikat 3 dhe 8 të vendimit.

## KONSTATIME TË TJERA

### 10. Shpenzime mjekësore për bashkëshorten

**10.1.** Lidhur me shpenzimet mjekësore për të ndjerën/bashkëshorten, në DIPP-të vjetore subjekti ka deklaruar: (i) në vitin 2014 – shuma 21.794 euro, fatura nga spitali “\*\*\*\*”, Turqi (shuma 2.000 euro paguar nga shoqëria e sigurimeve “\*\*\*\*”) dhe shuma 177.511 lekë nga spitali “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) në vitin 2015 – shuma 9.040 euro, fatura nga spitali “\*\*\*\*”, Turqi dhe shuma 485.404 lekë nga spitali “\*\*\*\*”, Tiranë; (iii) në vitin 2016 – shuma 4.000.000 lekë.

**10.2.** Shumat e deklaruara në DIPP-të vjetore janë konfirmuar nga subjekti edhe në pyetësorin standard<sup>97</sup>, shoqëruar me kopje të dokumentacionit provues<sup>98</sup>.

**10.3.** Pas përpunimit të dokumentacionit të administruar, në tabelën në vijim paraqiten shpenzimet mjekësore sipas faturave dhe sipas deklaramit të subjektit.

**Tabela nr. 8 – Shpenzimet mjekësore**

Viti	Institucioni					Total sipas faturave	Vlera e deklaruar në DIPP	Pasqyruar në analizë
	Spitali *** (Turqi) <sup>99</sup>	Hotel *** (Turqi)	Farmacii *** (Turqi)	Spitali *** Tiranë	*** (Tiranë)			
2014	3,054,555			177,513		3,232,068	3,228,671	<b>3,228,671</b>
2015	1,245,365			465,406		1,710,771	1,748,654	<b>1,748,654</b>

<sup>96</sup>Datë 17.11.2015, 1.000 lekë dhe datë 7.12.2015, 20.000 lekë.

<sup>97</sup>Procesverbal mbi dokumentacionin e dorëzuar në Komision në datën 31.1.2020 (nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, KPK). Subjekti ka konfirmuar: (i) shumën e deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 (21.794 euro dhe 177.511 lekë), gjithsej rreth 3.228.671 lekë; (ii) shumën e deklaruar në DIPP-në e vitit 2015 (9.040 euro dhe 484.404 lekë), gjithsej rreth 1.748.654 lekë; (iii) shumën e deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 (4.000.000 lekë).

<sup>98</sup>(1) VKM-ja nr. \*\*\*, datë 19.11.2014; (2) VKM-ja nr. \*\*\*, datë 13.7.2016; (3) mandat paradhënie datë 22.4.2016; (4) kopje të faturave të hotelit “\*\*\*\*” të datës 3.1.2016 - 6.1.2016 dhe të datës 17.4.2016 - 23.4.2016; (5) fatura tatimore shitje nga \*\*\* Hospital: 3 fatura të datës 1.4.2014; 1 faturë e datës 2.4.2014; 3 fatura të datës 3.4.2014; 1 faturë të datës 7.4.2014; (6) 17 fatura të spitalit “\*\*\*\*” (në turqisht) të vitit 2014; (7) 8 fatura të spitalit “\*\*\*\*” dhe 4 mandatarkëtime të vitit 2015; 10 fatura të spitalit “\*\*\*\*” të vitit 2015 (turqisht); (8) 9 fatura, 3 mandatarkëtime arkëtime nga spitali “\*\*\*\*” dhe 1 mandatarkëtime bankar për llogari të spitalit “\*\*\*\*” të viti 2016; (9) 2 mandatarkëtime nga laboratorit “\*\*\*\*”; (10) 19 fatura të spitalit “\*\*\*\*” të vitit 2016 (turqisht); (11) 2 fatura të lëshuara në vitin 2016 nga Dr. Z. D..

<sup>99</sup>Datat e faturave përputhen me periudhën gjatë së cilës subjekti dhe personat e lidhur kanë qenë në Turqi, referuar të dhënave nga sistemi TIMS.

2016	2,107,708	42,134	753,549	539,056	4,800	3,447,246	4,000,000	<b>4,000,000</b>
<b>Total</b>	<b>6,407,628</b>	<b>42,134</b>	<b>753,549</b>	<b>1,181,974</b>	<b>4,800</b>	<b>8,390,085</b>	<b>8,977,325</b>	<b>8,977,325</b>

**10.4.** Sa më lart, Komisioni mori në konsideratë në analizën financiare vlerat e deklaruara nga subjekti, në vlerën totale 8.977.325 lekë.

**10.5.** Nga analizimi i deklarimeve të subjektit në DIPP-të vjetore, si burim për këto shpenzime kanë shërbyer: (i) pakësimet e kursimeve ndër vite<sup>100</sup>; (ii) të ardhurat nga VKM-të (të trajtuara në pikën 7, të vendimit); (iii) kontributi vullnetar i Shoqatës së Prokurorëve<sup>101</sup>.

**10.6.** Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2014, 2015 dhe 2016 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, të pasqyruar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 9 – Analiza financiare për vitet 2014, 2015 dhe 2016**

Përshkrim	2014	2015	2016
Shtim likuiditete <i>cash</i> (të ardhurat nga VKM, tërhequr nga “Credins Bank”)	3,000,000	0	0
Pakësim likuiditete <i>cash</i>	-1,350,000	-850,000	-4,370,000
Shtim/pakësim likuiditete bankë	-8,631	11,660	3,003,153
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>1,641,369</b>	<b>-838,340</b>	<b>-1,366,847</b>
Të ardhura nga pagat e subjektit	1,282,135	1,285,148	1,280,908
Të ardhura nga pagat e të ndjerës/bashkëshortes	1,588,156	1,584,619	1,528,275
Të ardhura nga VKM-ja nr. ***, datë 19.11.2004, për mjekimin e bashkëshortes	3,091,974	0	0
Të ardhura nga VKM-ja nr. ***, datë 13.7.2016, për mjekimin e bashkëshortes	0	0	3,299,992
Kontribut vullnetar i Shoqatës së Prokurorëve për mjekimin e bashkëshortes	1,455,932	0	0
<b>Total të ardhura</b>	<b>7,418,197</b>	<b>2,869,767</b>	<b>6,109,175</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	879,992	897,104	940,368
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	909,314	401,938	330,059
Shlyerje detyrimi për EKB Lezhë	80,000	96,000	80,000
Shpenzime për mjekim për bashkëshorten	3,228,671	1,748,654	4,000,000
Rimbursim i shpenzimeve mjekësore nga shoqëria “*****”	0	0	0
<b>Total shpenzime</b>	<b>5,097,977</b>	<b>3,143,696</b>	<b>5,350,427</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura-ndryshim likuiditete-shpenzime)</b>	<b>678,851</b>	<b>564,411</b>	<b>2,125,595</b>

**10.7.** Sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e shpenzimeve mjekësore të së ndjerës gjatë periudhës 2014 – 2016.

<sup>100</sup>(i) DIPP/2014: pakësuar kursimet, ndër vite, të deklaruesit dhe bashkëshortes (për mjekim shëndetësor, *cash* 1.350.000 lekë); (ii) DIPP/2015: pakësuar kursimet, ndër vite, të deklaruesit dhe bashkëshortes (për mjekim shëndetësor, *cash* 850.000 lekë); (iii) DIPP/2016: pakësuar kursimet, ndër vite, të deklaruesit dhe bashkëshortes (kryesisht për mjekim shëndetësor të bashkëshortes së ndjerë e shërbime lidhur me të (4.370.000).

<sup>101</sup>Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar “kontribut vullnetar i Shoqatës së Prokurorëve për mjekim të bashkëshortes së deklaruesit”, vlera 1.378.000 lekë, 540 euro, 20 USD. Për të provuar këtë deklaram, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur: (i) deklaratë noteriale datë 12.5.2022, lëshuar nga ish sekretarja/arkëtare e ish-shoqatës së Prokurorëve të Shqipërisë, znj. P. E. e cila është personi që është marrë me administrimin e kontributeve vullnetare të kolegëve të së ndjerës dhe të mi, dhënë për mjekimin e së ndjerës E.; (ii) shkresë tip, përpiluar në kohën e konstatimit të sëmundjes së të ndjerës, firmosur nga ish-Kryetari i Shoqatës së Prokurorëve të Shqipërisë, Tiranë, z. Sh. H. , datë 15.5.2014, drejtuar prokurorive në vend, për shprehjen e solidaritetit lidhur me mjekimin e kurimin e të ndjerës, (iii) shkresa përgjigje, të drejtuar shoqatës së prokurorëve nga disa prokurori, së bashku me shënimet përkatëse, mbajtur nga arkëtarja e shoqatës, lidhur me kontributin vullnetar, dhënë për kurimin e së ndjerës, nga prokurorë dhe punonjës të tjerë të prokurorive (opgj/sekretare etj.).

**10.8. Në përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e shpenzimeve mjekësore të së ndjerës E. G. gjatë periudhës 2014 – 2016.

## **11. Bashkëpronar në apartamentin e privatizuar me sip. 71 m<sup>2</sup>, në Shkodër**

**11.1.** Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Shkodër<sup>102</sup> rezulton se sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme apartament me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Shkodër, subjekti është bashkëpronar në këtë pasuri me shtetasit M. M. G., F. Sh. G. dhe Sh. M. G. Kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017.

**11.2.** Nga shqyrtimi i origjinës së regjistrimit të pronës rezulton se shtetasi M. G. ka qenë përdorues i apartamentit të mësipërm dhe në bazë të ligjit për privatizimin e banesave shtetërore ka kërkuar privatizimin e tij. Referuar ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, banesat që privatizohen regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij<sup>103</sup>, duke marrë si bazë përbërjen familjare dhe gjendjen e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1.12.1992<sup>104</sup>. Sipas certifikatës së përbërjes familjare të shtetasit M. G. në datën 1.12.1992, anëtarë të familjes ishin M. G., F. G., Shpëtim Garuja dhe S. G. dhe sipas kartelës së pasurisë së paluajtshme apartamenti është regjistruar në ZVRPP në datën 7.12.1995, në bashkëpronësi të të gjithë anëtarëve.

**11.3.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhje me konstatimin se: *Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën Vetting 2017, bashkëpronësinë në apartamentin nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Shkodër, sipas parashikimit në paragrafin 1 të nenit 31 dhe në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016.*

**11.4.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>105</sup>, subjekti shpjegon se apartamenti i mësipërm është shitur që në datën 18.9.1995 dhe se është zhveshur nga kjo pasuri, si dhe ka paraqitur aktin e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.9.1995, ku pasqyrohet se shtetasit M. G., F. G., Sh. G. dhe S. G. i kanë shitur shtetasve B. P. dhe V. P. apartamentin 2 +1, në pallatin nr. \*\*\*, kati \*\*\*.

**11.5.** Komisioni, pasi u njoh me dokumentin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit ka paraqitur prova të mjaftueshme lidhur me rezultatin e hetimit.

**11.6. Në përfundim**, Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika për këtë pasuri që lidhen me procesin e rivlerësimit.

## **12. Banesa në përdorim në vitet 1995 – 2001, në Shkodër**

**12.1.** Në përgjigje të pyetësorit standard<sup>106</sup>, lidhur me adresat ku ka banuar nga momenti i marrjes së detyrës, subjekti deklaroi se: *“Gjatë kësaj periudhe, përpara blerjes së banesës tonë*

<sup>102</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020.

<sup>103</sup>Ligji nr. 7652/1992, neni 9: *“Banesat që privatizohen, do të regjistrohen në emër të qiramarrësit dhe anëtarëve të tjerë madhorë të familjes së tij”.*

<sup>104</sup>Ligji nr. 7652/1992, neni 20: *“Për efekt të zbatimit të këtij ligji, të merret për bazë përbërja familjare dhe gjendja e strehimit që rezulton në regjistrat themeltarë të shtetasve në datën 1 dhjetor 1992”.*

<sup>105</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

<sup>106</sup>Procesverbal mbi dokumentacionin e dorëzuar pranë Komisionit më 30.1.2020 (nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, KPK).

ku jetojmë dhe aktualisht kemi banuar përkohësisht në banesën e gjyshërve të ish-bashkëshortes së ndjerë te të ndjerët S. Gr. (D.) dhe Q. Gr. ne rrugën ‘\*\*\*’, Shkodër dhe më pas te banesa e prindërve të ish-bashkëshortes së ndjerë, te shtetasit Xh. dhe S. B., ndodhur në Rrethin e Shkodrës, ku nuk kemi paguar qira”.

#### **Përdorimi i banesës së shtetasit S. G. (D.)**

**12.2.** Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Shkodër<sup>107</sup> rezulton se në kartelën e pasurisë së paluajtshme të llojit “apartament” me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, h. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, pasqyrohen transaksionet e bëra për këtë pasuri ku, fillimisht, subjekti dhe bashkëshortja E. G., sipas regjistrimit të datës 15.12.1995, figurojnë bashkëpronarë të kësaj pasurie dhe, më pas, kjo pasuri kalon në pronësi të shtetasve S. S. B., ku në kolonën “Shuma e paguar” shënohet “Dhurim” dhe më pas kalon në pronësi të shtetasve S. dhe S. D.. Pjesë e dokumentacionit të ASHK-së janë autorizimi i Komitetit Ekzekutiv i K.P. Qytetit Shkodër, i datës 11.4.1972, me anë të të cilit autorizohet shtetasi S. G. të lidhë kontratë qiramarrje me NSHK Banesa për dy dhoma e një kuzhinë në banesën shtetërore, në lagjen “\*\*\*\*”, në pallatin te \*\*\*, h. \*\*\*, k. \*\*\*, si dhe dokumentet e privatizimit<sup>108</sup> të plotësuar dhe të nënshkuara në emër të z. S. D.

**12.3.** Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK-ja nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij të ishin qiramarrës të banesës shtetërore ku banonin shtetasit S. dhe Q. D. përpara datës 1.12.1992, si dhe nuk figuron në përbërje familjare me këta shtetas në këtë datë.

**12.4.** Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqesë shpjegime lidhur me konstatimin se: *Mbetet i paqartë pasqyrimi në kartelën e pasurisë së paluajtshme të ASHK-së (sipas regjistrimit të datës 15.12.1995) emri i subjektit dhe bashkëshortes së tij, E. G., si bashkëpronarë të pasurisë apartament, ndërkohë që dokumentet e privatizimit janë plotësuar dhe nënshkuar në emër të z. S. D.*

**12.5.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>109</sup> subjekti shpjegon se emri i tij është pasqyruar në atë banesë për shkak të faktit se ka deklaruar që ka banuar përkohësisht në atë banesë.

**12.6.** Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin që subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e kanë kaluar pjesën e bashkëpronësisë me dhurim shtetasve S. S. B. (nëna e bashkëshortes), vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me fitimin e bashkëpronësisë në apartamentin e mësipërm.

**12.7. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika për përdorimin e banesës së shtetasit S. G., që lidhen me procesin e rivlerësimit.

*Përdorimi i banesës së prindërve të ish-bashkëshortes së ndjerë, shtetasve Xh. dhe S. B. në Shkodër*

<sup>107</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020.

<sup>108</sup>Formulari nr. 1 “treguesit tekniko-ekonomik të banesës”; formulari nr. 2, “treguesit kryesorë për apartamentin”; planimetria e apartamentit në emër të qytetarit S. D.; formulari nr. 3, “kontratë për privatizimin e banesës”.

<sup>109</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

**12.8.** Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Shkodër<sup>110</sup>, rezulton se shtetasi Xh. B. figuron pronar i pasurisë apartament me sip. 80 m<sup>2</sup>, me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, Shkodër. Sipas dokumentacionit të origjinës së regjistrimit të kësaj prone<sup>111</sup> rezulton se shtetasi Xh. B. e ka privatizuar nga shteti këtë apartament dhe bazuar në gjendjen familjare të datës 1.12.1992 kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasve Xh. B., S. B. dhe A. B.

**12.9.** Nga analizimi i dokumentacionit të mësipërm vërtetohet se në periudhën që ka deklaruar subjekti për përdorimin e banesës prej tij dhe bashkëshortes, shtetasit Xh. dhe S. B. dispononin apartamentin me sip. 80 m<sup>2</sup>, në Shkodër.

**12.10. Në përfundim,** Komisioni nuk konstaton problematika për përdorimin e banesës së shtetasve Xh. dhe S. B. në qytetin e Shkodrës që lidhen me procesin e rivlerësimit.

### **13. Analiza financiare**

**13.1.** Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur, për periudhën 1993 – 2016, nga ku rezultoi një balancë negative në vlerën 103.906 lekë për periudhën 1993 – 2003, ndërsa për periudhën 2004 – 2016 rezultuan balanca pozitive në fund të secilit vit kalendarik.

**13.2.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>112</sup> subjekti i rivlerësimit ka parashtruar pretendime lidhur me mosparaqitjen në analizën financiare të të ardhurave të tij për periudhën 1988 – 1992 dhe të të ardhurave të bashkëshortes së ndjerë për periudhën 1991 - 1992. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur pretendimet e tij lidhur me periudhën e kryerjes së investimit në apartament, duke shpjeguar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni, këto shpenzime janë konsideruar deri në vitin 2001, ndërkohë që në pyetësoin standard ai ka deklaruar se ky shpenzim është kryer deri në fund të vitit 2003. Sipas subjektit, shpenzimi për investim duhet të llogaritet si shpenzim në analizën financiare për vitet 2001 – 2003. Në tabelat e analizës financiare për periudhat 1993 – 2001 dhe 2002 – 2003, të paraqitura në Komision, pasqyrohet shpërndarja e vlerës së investuar në dy vite, konkretisht, 758.000 lekë në vitin 2001 dhe 1.742.000 lekë në vitin 2003.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**13.3.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**13.4.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të paraqitur në analizën financiare të ardhurat e përfutuara përpara vitit 1993, Komisioni vlerëson se këto të ardhura nuk mund të përfshihen në analizën financiare. Ky qëndrim bazohet në jurisprudencën orientuese të

<sup>110</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020.

<sup>111</sup>Kërkesë për privatizim; formulari nr. 1 “Treguesit tekniko-ekonomik të banesës”; certifikatë e gjendjes familjare në datën 1.12.1992; vërtetim datë 26.6.1995; formulari nr. 2, “Treguesit kryesorë për apartamentin”; (3) planimetria e apartamentit në emër të qytetarit Xh. B.; planvendosje e objektit; librezë e Nish Elektrikut; autorizim datë 11.4.1972; akti i marrjes në dorëzim i banesës; raport teknik datë 24.3.1973.

<sup>112</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>113</sup>, i cili ka arsyetuar se: “[...] periudha kohore para ndryshimeve demokratike në vend, që përkon me vitet 1991-1992, nuk mund të jetë si rregull një periudhë e cila mund të llogaritet në funksion të përcaktimit të ndonjë vlere të kursyer, për shkak të një realiteti të jetuar që ka provuar se monedha zyrtare, leku, në këtë periudhë pësoi një inflacion në nivele shumë të larta e të jashtëzakonshëm, produkt i ndryshimeve politike, sociale dhe ekonomike në vend që e bën të pabesueshme dhe të palogjikshme mundësinë potenciale të kursimit nga të ardhurat nga puna në këto periudha. Për pasojë, pasi monedha vendase hyri në një fazë stabiliteti, pas viteve 1992-1993, mundësia për të kursyer mund të konsiderohet si opsion [...]”.

**13.5.** Lidhur me pretendimin për periudhën gjatë së cilës janë kryer investimet në apartament, në prapësimet e tij subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se apartamenti në Tiranë ka pasur disa të meta teknike në momentin e blerjes (të tilla si ngritje të pllakave të dyshemesë, rrjedhje uji në kolonën kryesore, plasaritje dhe çarje të suvasë së mureve etj.). Në vijim të këtyre deklaramenteve, Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i subjektit se investimi në apartament është kryer përgjatë periudhës 2001 – 2003, për shkak se kushtet në të cilat është blerë ky apartament (të përshkruara nga subjekti) duket se e bëjnë të pamundur fillimin e banesës pa kryer investime domethënëse, ndërkohë që subjekti ka deklaruar që ka filluar të banojë në këtë apartament pas blerjes së tij.

**13.6.** Referuar arsyetimit në paragrafët 1.27-1.38, të vendimit, Komisioni përfshiu shumën 2.258.000 lekë në analizën financiare, e cila paraqitet në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 10 – Analiza financiare për periudhën 1993 – 2016**

Viti	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
1993-2003	4,000,000	240,000	0	8,533,848	2,026,800	4,166,554	2,154,094
2004	0	350,000	0	2,277,859	-87,000	454,299	1,386,561
2005	0	650,000	46,223	2,615,773	-86,900	501,228	1,331,422
2006	3,134,880	99,920	17,604	2,551,701	2,019,900	595,969	723,228
2007	0	1,210,000	-131,829	2,604,243	-95,300	942,379	488,393
2008	0	1,540,000	57,575	2,806,974	-79,500	894,032	235,868
2009	0	122,100	10,800	2,947,090	-1,414,200	933,887	466,103
2010	0	360,000	681,624	3,238,570	-111,300	826,876	1,258,770
2011	0	1,400,178	-680,125	2,937,830	-87,850	878,400	1,251,527
2012	0	350,000	9,628	2,886,519	-513,600	571,082	1,442,209
2013	980,700	-830,700	11,236	2,814,953	-164,000	564,096	1,925,621
2014	0	1,650,000	-8,631	7,418,197	-80,000	5,017,977	678,851
2015	0	-850,000	11,660	2,869,767	-96,000	3,047,696	564,411
2016	0	-4,370,000	3,003,153	6,109,175	-80,000	5,270,427	2,125,595
<b>TOTAL</b>	<b>8,115,580</b>	<b>1,921,498</b>	<b>3,028,917</b>	<b>52,612,499</b>	<b>1,151,050</b>	<b>24,664,901</b>	<b>16,032,653</b>

**13.7. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme, ndër vite, për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve.

<sup>113</sup>Vendimi nr. 15-2021 (JR), datë 18.6.2021.



## **Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë**

### **14. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:**

*Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 86,5 m<sup>2</sup>, me vlerën 4.000.000 lekë, në Tiranë, subjekti i rivlerësimit:*

- i. ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ii. dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në shumën 1.500.000 lekë dhe për kryerjen e investimit në të në shumën 2.500.000 lekë;
- iii. lidhja e kontratës së shitjes me këste, me kusht nr. \*\*\*, datë 1.8.2001, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe EKB-së Lezhë është bërë me qëllim shmangien e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”, i ndryshuar.

*Lidhur me pasurinë apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>, me vlerë 25.200 euro, në zonën \*\*\*, Durrës, subjekti i rivlerësimit:*

- i. ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ii. dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës 21.200 euro për blerjen e apartamentit në Durrës.

*Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf”, me vlerë 7.000 euro:*

- i. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me çmimin e blerjes së automjetit në shumën 7.000 euro është i pasaktë, pasi nuk mbështetet në dokumentacionin justifikues, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës 7.000 euro për blerjen e automjetit.

*Lidhur me deklarimin e gjendjes cash në shumën 980.000 lekë:*

- i. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 980.000 lekë.

**15. Në përfundim**, trupi gjykues i Komisionit, duke marrë në konsideratë faktin se nga hetimi administrativ i pasurisë rezulton se subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja ndodhet në kushtet e deklaramit të saktë, me burime të ligjshme financiare për krijimin e pasurive, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlerëson se pavarësisht se lidhja e kontratës së shitjes me këste, me kusht nr. \*\*\*, datë 1.8.2001 ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe EKB-së Lezhë është bërë me qëllim shmangien e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit në familjet e pastreha”, i ndryshuar dhe përbën veprim në kundërshtim me etikën e prokurorit, ky fakt i vetëm nuk përbën shkak që ndaj subjektit të rivlerësimit të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

## B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, të deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramentit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Komisioni kërkoi nga DSIK-ja rishikimin e raportit mbi kontrollin e figurës së z. Shpëtim Garunja. Në përgjigje<sup>114</sup>, DSIK-ja bën me dije se nuk ka të dhëna të cilat mund të shërbejnë si bazë për rishikimin e raportit për kontrollin e figurës.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

### Hetimi i Komisionit

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja Shkodër<sup>115</sup> rezulton se sipas certifikatës për përbërjen familjare deri në datën 1.12.1992, pjesë e dosjes së privatizimit të banesës shtetërore nga shtetasi S. D. dhe sipas certifikatës së përbërjes familjare të shtetasit M. G., në datën 1.12.1992, pjesë e dosjes së privatizimit të banesës shtetërore nga ky shtetas, subjekti ka pasur mbiemrin G.

6. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga KLP-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, Komisioni konstaton se bashkëlidhur procesverbalit “Për marrjen në dorëzim të formularit të vetëvlerësimit profesional dhe dokumentacionit bashkëngjitur tij nga subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja” gjendet kopje e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 4.9.1995, “Për emërimin kuadri”, e Prokurorisë së Përgjithshme në të cilën pasqyrohet se: “Me vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nr. \*\*\*, datë 30.8.1995, Shpëtim Garunja, hetues ushtarak në Prokurorinë e Rrethit Shkodër, emërohet prokuror ushtarak në Prokurorinë Ushtarake Shkodër”. Në vijim dhe në shkresat e tjetra të Prokurorisë së Përgjithshme dhe në dekretet e Presidentit<sup>116</sup>, ku pasqyrohen transferimet e subjektit në prokuroritë e rretheve të ndryshme, subjekti rezulton me mbiemrin Garunja.

<sup>114</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2022.

<sup>115</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2020.

<sup>116</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.2.1996; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.1.1998; dekreti nr. \*\*\*, datë 30.4.2007; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.5.2007; dekreti nr. \*\*\*, datë 6.10.2010; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2010.

7. DPGJC-ja<sup>117</sup> informon se shtetasi Shpëtim Garunja, në datën 27.11.2002, ka ndryshuar përbërësin e gjendjes civile, rubrikën e mbiemrit nga Garuja në Garunja, si dhe ka përcjellë aktet mbi bazën e të cilit është bërë ndryshimi i mbiemrit<sup>118</sup>. Referuar dokumentacionit të përcjellë rezulton se me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2002, Prefekti i Qarkut Shkodër shprehet mbi ligjshmërinë e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.11.2002, të Këshillit dhe për zbatimin e tij. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet një pjesë e listës së personave që kanë kërkuar ndryshimin e emrit dhe mbiemrit ku figuron edhe emri i subjektit të rivlerësimit për të cilin është vendosur ndryshimi i mbiemrit nga Garuja në Garunja. Gjithashtu, konstatohet se në certifikatën personale<sup>119</sup> të Zyrës së Gjendjes Civile të Bashkisë Shkodër është vendosur shënimi “*ndryshim mbiemri nga Garuja në Garunja, akti \*\*\*, datë 27.11.2002*”.

8. Komisioni<sup>120</sup> i kërkoi shpjegime subjektit lidhur me faktin se në deklaratën për kontrollin e figurës dhe në formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr. 138/2016, nuk ka deklaruar ndryshimin e mbiemrit nga Garuja në Garunja. Në përgjigje<sup>121</sup>, subjekti ka deklaruar se nuk e ka ndryshuar mbiemrin edhe gjatë viteve, para vitit 2002, si në shkollë ashtu edhe në punë, në çdo vend tjetër ka përdorur mbiemrin Garunja. Në vijim, shpjegon se në të gjitha dokumentet që administron, si dëftesa e shkollës së mesme e vitit 1982, libreza ushtarake, dy diploma të arsimit të lartë, libreza e punës e lëshuar që në vitin 1988 nga ish Hetuesia e Përgjithshme Tiranë, etj., si dhe në të gjitha kopjet e pasaportave të tij dhe të familjarëve të tij ka përdorur mbiemrin që ka sot Garunja. Më pas, subjekti shpjegon se rreth vitit 1994 ka marrë dijeni në mënyrë rastësore se në Zyrën e Gjendjes Civile ishte shënuar gabim mbiemri nga Garunja në Garuja dhe i ka kërkuar kësaj zyre që të bëjë korrigjimet dhe saktësimin e mbiemrit. Mbiemrin Garuja, shpjegon subjekti, nuk e ka përdorur asnjëherë dhe nisur nga fakti se nuk e ka përdorur asnjëherë dhe ishte thjesht një saktësim formal, ka vlerësuar se nuk është i nevojshëm ky deklarim dhe saktësim formal, pasi ishte një gabim material i bërë nga Zyra e Gjendjes Civile, siç është gjetur me gabime rëndom kjo zyrë. Për vërtetimin e deklarimit të tij ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>122</sup>.

9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura nga subjekti rezulton se në dokumentet e identifikimit dhe në ato arsimore të lëshuara nga organet shtetërore nga viti 1979 e në vijim, subjekti figuron me mbiemrin Garunja. Gjithashtu, sipas vendimit të emërimit si prokuror në vitin 1995 dhe në dekretet e Presidentit të Republikës për transferimin e tij në Prokuroritë e Rretheve të ndryshme subjekti figuron me mbiemrin Garunja. Në këto kushte, duket se deklarimi i subjektit mbështetet në dokumentacionin justifikues.

10. Në përfundim, Komisioni konstaton se subjekti nuk ka deklaruar ndryshimin e mbiemrit nga Garuja në Garunja në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr.

---

<sup>117</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2022.

<sup>118</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2002, e Prefektit të Qarkut Shkodër; certifikatë personale e Zyrës së Gjendjes Civile Shkodër.

<sup>119</sup>Fotografuar pa datë.

<sup>120</sup>E-mail datë 19.5.2022.

<sup>121</sup>E-mail datë 21.5.2022.

<sup>122</sup>Kopje të librezës ushtarake, datë 15.3.1979; dëftesë pjekurie datë 2.7.1982; diplomë datë 14.6.88; librezë studenti datë 13.12.1989; kartë studenti datë 30.8.1984; librezë pune datë 10.3.1988; diplomë datë 8.7.1994; kopje të pasaportës së datës 19.7.1995; kopje të pasaportës datë lëshimi 14.12.2002; kopje të pasaportës datë 14.1.2011; kopje të pasaportës datë 24.10.2020; kopje të kartave të identifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme vitet 1996, 1998; certifikatë kursi viti 1999; kopje të pasaportave të bashkëshortes dhe fëmijëve; të dhëna nga sistemi *TIMS* në emër të kushërinjve të parë (djem të xhaxhait).

84/2016, pavarësisht se ka dhënë shpjegime të mjaftueshme dhe ka paraqitur dokumentacionin justifikues që provon se ka përdorur gjithmonë mbiemrin Garunja.

**11.** Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**1.** Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

**2.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**3.** Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**4.** Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit së bashku me tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin, të paraqitura nga subjekti; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënive me Shërbimet Informativë dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënive me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

**5.** Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit: me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.8.1995, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është emëruar prokuror ushtarak dhe nga shtatori i vitit 1995 deri në shkurt të vitit 1996 ka ushtruar funksionet e prokurorit ushtarak në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër; në periudhën shkurt 1996 – janar 1998 ka ushtruar funksionet e prokurorit të rrethit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Pukë; në periudhën shkurt 1998 – prill 2007 ka ushtruar funksionet e prokurorit të rrethit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; në periudhën maj 2007 – tetor 2010 ka ushtruar funksionet e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nga tetori i vitit 2010 e në vazhdim ushtron funksionet e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **Aftësitë profesionale**

### *Njohuritë ligjore*

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ai është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të tij, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu edhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që ka pasur në ndjekje. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet e zbatimit të saj në rastin konkret.

### *Arsyetimi ligjor*

Bazuar në tri aktet e dorëzuara dhe në pesë dosjet e shortuara konstatohet se subjekti i rivlerësimit, në përgjithësi, shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e pasqyrit të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese është e qartë dhe të kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore.

## **Hetimi i Komisionit**

**6.** Pavarësisht raportit të dërguar nga KLP-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dokumentin nr. 1 të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe dosjet 2 dhe 5, të shortuara, si vijon:

**7. Lidhur me dokumentin nr. 1** – kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2013, që i përket të pandehurve E. K. dhe K. D., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka bërë një analizë të elementeve të figurës së veprës penale “vjedhje”, në bashkëpunim, të parashikuar nga paragrafi 2, i nenit 134, i Kodit Penal.*

**8.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>123</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se shënimi i elementëve të figurës së veprës penale nuk është pasqyruar në kërkesën për gjykim pasi fakti, lidhur me këtë vepër penale, ka qenë i qartë, hetimi ka qenë i plotë dhe nuk ka pasur pretendime nga palët lidhur me cilësimin e veprës penale. Më tej, ka sqaruar se kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka lënë të njëjtin cilësim të veprës penale të bërë nga organi akuzues dhe ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur si provë vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **Analiza e Komisionit**

**9.** Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 26.7.2013, rreth orës 16:15 është njoftuar Policia e Shtetit se në banesën e familjes Rr., në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, kanë hyrë

---

<sup>123</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

me thyerje dy persona, por që janë parë e ndjekur nga familjarë të të dëmtuarve, të cilët kanë arritur të kapin njërin nga autorët, të dyshuarin K. D., kurse bashkëpunëtori tjetër, i identifikuar E. K., ka arritur fillimisht të fshihet dhe të largohet pa u kapur. Në banesë autorët kanë arritur të vjedhin një çantë lëkure me ngjyrë të zezë, brenda së cilës ka pasur 150 euro dhe 20 USD. Në përfundim të veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur përpara gjykatës kërkesën për gjykimin e procedimit penal që i përket të pandehurve E. K. dhe K. D., të akuzuar për kryerjen e veprës penale “vjedhje”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.5.2014, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurve për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal dhe ka caktuar masën e dënimit për secilin prej tyre.

**10.** Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit të gjykatës rezulton se të pandehurit kanë kërkuar gjykim të shkurtuar dhe gjykata, duke vlerësuar se aktet e hetimit paraprak ishin të plota, nuk përmbanin ndonjë pavlefshmëri dhe nuk kontestoheshin nga palët në gjykim, e ka gjendur të drejtë cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori, ka pranuar kërkesën e të pandehurve dhe në fund i ka shpallur fajtor duke i dhënë masën përkatëse të dënimit secilit prej tyre. Në fund të vendimit pasqyrohet shënimi se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.3.2015.

**11.** Sa më sipër, Komisioni, duke marrë në konsideratë se fakti lidhur me këtë veprë penale ka qenë i qartë, nuk ka pasur pretendime nga palët lidhur me cilësimin juridik të veprës penale dhe gjykata i ka vlerësuar të plota aktet e hetimit, si dhe e ka vlerësuar të drejtë cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me konstatimin e Komisionit.

**12. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

**13. Lidhur me dosjen nr. 2,** që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2014, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen e veprës penale “mosbindje ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal. Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për konstatimin se: *(i) subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për të vërtetuar anën objektive të veprës penale, “mosbindja ndaj urdhrin të punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, pasi nuk ka administruar aktin e organit shtetëror për mbylljen e tregut dhe ndalimin e makinave me mall; (ii) subjekti nuk ka analizuar elementin e anës subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal.*

**14.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>124</sup>, subjekti i rivlerësimit fillimisht shpjegon se është dakord me gjetjet e Komisionit dhe më pas shpjegon se në urdhrin e delegimit të veprimeve hetimore policisë gjyqësore ka kërkuar këqyrjen dhe marrjen nga shtetasit L. e L. B. dokumentacionin që kanë ato për kryerjen e aktivitetit, por edhe njoftimet e bëra atyre lidhur me mbylljen e tregut dhe transferimin në një vend tjetër. Gjithashtu, pranon se nga policia gjyqësore nuk është administruar akti i mbylljes së tregut dhe i ndalimit të hyrjes së mjeteve, çka përbën, shpjegon subjekti, se fakti mbetet i dyshimtë, dyshim i cili nga ligji çmohet në

---

<sup>124</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

favor të të pandehurit. Më pas pranon se në arsyetimin e vendimit të pushimit mund të analizoheshin në mënyrë teorike elementët e figurës së veprës penale, por për shkak të mosngritjes së ndonjë pretendimi nga palët, ngarkesës në punë dhe fakti ishte i qartë rasti është analizuar në mënyrë të përmbledhur.

### **Analiza e Komisionit**

**15.** Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 30.8.2014 ka bërë kallëzim penal shtetasi S. H., me detyrë punonjës policie në sektorin e objekteve të Komisarariatit të Policisë nr. \*\*\*, Tiranë, i cili ka shpjeguar se së bashku me dy kolegët e tij është ngarkuar nga eprorët me shërbim te tregu i uzinës “\*\*\*”, që të mos lejonin që të futeshin automjete të ngarkuara me mall në këtë treg. Në hyrje të tregut ka shkuar shtetasi L. B. me automjetin e tij, i cili kishte ngarkuar djathë dhe hurrë për t’i futur në treg, aty ku ka dyqanin e shitjes. Kallëzuesi dhe kolegu i tij e kanë sqaruar se nuk lejohej. Me gjithë debatin, ai është bindur për momentin dhe e ka larguar automjetin më tej. Në këtë moment ka shkuar bashkëshortja e tij dhe nga automjeti ka marrë një fuçi dhe e ka tërhequr zvarrë dhe e ka futur atë brenda tregut. Pastaj ka marrë edhe një fuçi tjetër dhe i ka sharë e ofenduar ata dhe ka derdhur fuçinë e hurrës dhe djathit te hyrja e tregut, duke krijuar rrëmujë. Kanë marrë në telefon sallën operative të policisë dhe aty kanë shkuar dy automjete të Komisarariatit nr. \*\*\* dhe kanë kryer shoqërimin e tyre në komisarariat. Me vendimin e datës 6.1.2015, subjekti ka vendosur pushimin e çështjes penale me argumentin se mungojnë elementet e veprës penale “mosbindje ndaj urdhrit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal, me arsyetimin se *nuk rezulton të jetë kryer vepra penale e parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal*, pasi mungojnë elementet e kësaj vepre penale, konkretisht, ana subjektive.

**16.** Komisioni arsyeton se për t’u konsideruar dhe konsumuar ana objektive e figurës së veprës penale “mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik”, e parashikuar nga neni 242<sup>125</sup> i Kodit Penal, duhet të jenë kryer veprime aktive që konsistojnë në refuzimin e kryerjes së veprimeve të urdhëruara nga ana e punonjësit të policisë së rendit publik. Gjithashtu, në rastin e kësaj vepre penale e rëndësishme është që urdhri që jep punonjësi i policisë së rendit publik të jetë i ligjshëm dhe për të vërtetuar nëse urdhri është i ligjshëm apo jo, kërkohet referimi te kuadri ligjor që rregullon ushtrimin e detyrës së punonjësit të policisë, si dhe të legjislacionit specifik që rregullon marrëdhënien konkrete (në rastin konkret mbylljen e tregut nga organet shtetërore). Gjithashtu, duhet të ekzistojë ana subjektive që veprimet e të pandehurit duhet të jenë kryer me dashje dhe ky të ketë mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale dhe të jetë i përgjegjshëm.

**17.** Komisioni konstaton se gjatë hetimeve paraprake nuk është administruar akti i organit shtetëror për mbylljen e tregut tek “\*\*\*” dhe/ose për moslejimin automjeteve të ngarkuara me mall. Vetëm pas administrimit të këtij akti, mund të analizohej nëse nga ana objektive është konsumuar vepra penale e parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal si ligjshmëria e urdhrit të punonjësit të policisë për ndalimin e hyrjes së automjeteve në treg dhe nëse veprimet e shtetases L. B. përbëjnë ose jo refuzim të kryerjes së këtij urdhri. Gjithashtu, rezulton se subjekti i

---

<sup>125</sup>Kodi Penal, neni 242: “Mosbindja ndaj urdhrave të ligjshme të punonjësit të policisë së rendit publik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj”.

rivlerësimit, në vendimin e pushimit, nuk ka analizuar anën subjektive të veprës penale nëse veprimet e shtetas L. B. janë kryer ose jo me dashje.

**18. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe në aspektin e arsytimit ligjor bazuar në treguesin e cilësisë së analizës, kritere të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

**19. Lidhur me dosjen nr. 5,** që i përket procedimit penal nr. \*\*\*, datë 9.5.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në ngarkim të të pandehurës P. S., e akuzuar për kryerjen e veprës penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektivit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka analizuar elementët e figurës së veprës penale për të cilën akuzohet e pandehura, si dhe nuk ka arsyetuar se pse në rastin konkret janë konsumuar elementët e kësaj vepre penale.*

**20.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>126</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se është dakord me konstatimin e Komisionit dhe sqaron se mospasqyrimi i elementëve të figurës së veprës penale ka ardhur për shkak se fakti ka qenë i qartë, nuk ka pasur pretendime nga palët dhe thekson se ngarkesa në punë ka ndikuar në cilësisë e akteve të përpiluara në atë kohë dhe në vazhdim. Në vijim, shpjegon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dënimin e të pandehurës për kryerjen e veprës penale të akuzuar. Gjithashtu, ka paraqitur si provë vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Analiza e Komisionit**

**21.** Në datën 6.4.2016, ka bërë kallëzim penal pranë Komisarariatit të Policisë nr. \*\*\* Tiranë, shtetasja U. M., me detyrë punonjëse e patrullës së përgjithshme të policisë në këtë komisarariat, e cila në kallëzimin e saj ka shpjeguar se në këtë datë ka qenë në shërbim patrulle në Rugën e \*\*\* dhe rreth orës 12:30, pranë vilës “\*\*\*”, kanë konstatuar një mjet, i cili ishte parkuar gabim në rrugëkalim mjetesh dhe janë afruar për të vendosur gjobë lidhur me shkeljen. Nga një lokal përballë mjetit kanë dalë dy zonja, të cilat po bërtisnin dhe po shanin në drejtimin e tyre. Njëra nga ato, shtetasja P. S., drejtuese e mjetit, me veprime konkrete e ka kundërshtuar, duke i kapur bllokun e gjobave dhe nuk e ka lejuar të merrte masën administrative për shkeljen e konstatuar e të kryente detyrën e saj dhe e ka ofenduar. Kallëzuesja shpjegon se nuk i ka kthyer përgjigje po ia ka marrë bllokun e kundërvajtjeve dhe e ka mbushur fletën e gjobës sipas ligjit dhe për shkak të situatës ka lajmëruar shërbimet e policisë, të cilët kanë bërë shoqërimin e shtetas P. S. në Komisarariatin e Policisë.

**22.** Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar gjykimin e procedimit penal në ngarkim të të pandehurës P. S. për kryerjen e veprës penale “kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.10.2016, e ka shpallur fajtores të pandehurën për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 236/1 i Kodit Penal duke i dhënë masën përkatëse të dënimit.

---

<sup>126</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektivit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).



**23.** Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit të gjykatës rezulton se e pandehura ka kërkuar gjykim të shkurtuar, ka pranuar veprimet e saj ndaj punonjëses së policisë dhe ka kërkuar falje. Gjykata e ka gjendur të drejtë cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori dhe në fund e ka shpallur fajtores të pandehurën duke i dhënë masën përkatëse të dënimit. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 21.10.2016, pasi nuk është ankimuar. Komisioni, duke marrë në konsideratë se fakti lidhur me këtë veprë penale ka qenë i qartë, hetimi ka qenë i plotë dhe nuk ka pasur pretendime nga e pandehura lidhur me cilësimin e veprës penale dhe gjykata e ka vlerësuar të drejtë cilësimin juridik të veprës penale të përcaktuar nga prokurori, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me konstatimin e Komisionit.

**24. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuar nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

### **Aftësitë organizative**

#### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Rezulton se subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 ka trajtuar gjithsej 978 çështje, ku 350 janë çështje për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal; 38 çështje për të cilat është marrë vendim pushimi; 152 çështje të dërguara për gjykim; 438 çështje për të cilat është vendosur pezullimi i procedimit penal. Nga gjetjet në dokumentet ligjore të përzgjedhura në bazë të shortit të zhvilluar për periudhën 2013 – 2016 rezulton se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke i kryer hetimet, drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

#### *Aftësia për të kryer procedurat hetimore*

Subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja rezulton se ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga ana e tij është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të dërguara për gjykim. Sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit.

#### *Aftësia për të administruar dosjet*

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe nga pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *Etika në punë*

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë.

### *Integriteti*

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### *Paanësia*

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

## **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

### *Aftësia e komunikimit*

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit të rivlerësimit me pjesëmarrësit në proces.

### *Aftësia për të bashkëpunuar*

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cilësi të mira bashkëpunuese dhe tregohet i gatshëm të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese, si dhe është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

### *Gatishmëria për t'u angazhuar*

Prokurori Shpëtim Garunja, nga të dhënat në dosjen personale, ka pjesëmarrje në 27 trajnime. Lënda e trajnimeve ku ka marrë pjesë kanë lidhje me detyrën e prokurorit.

## **Të dhëna nga burimet arkivore të KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme**

**25.** Komisioni, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2021, i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme nëse nga prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit Shpëtim Garunja. Prokuroria e Përgjithshme<sup>127</sup> ka përcjellë pranë Komisionit informacionin si vijon:

**26.** Nga sektori i protokoll-arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja janë paraqitur ankesat: praktika nr. \*\*\* e vitit 2010 nga shtetasi B. H.; dhe praktika nr. \*\*\* e vitit 2018 nga shtetasja T. D..

**27.** Nga praktika nr. \*\*\* e vitit 2010 rezulton se shtetasi B. H. i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një kërkesë ankimore për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 24.11.2009, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, regjistruar në ngarkim të shtetases F. N. për veprën penale “shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”. Në

---

<sup>127</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2022.

kërkesën ankimore, shtetasi B. H. ka parashtruar pretendimet e tij dhe ka kërkuar prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Drejtoria e kontrollit të hetimeve dhe ndjekjes penale pranë Prokurorisë së Përgjithshme, me vendimin e datës 5.10.2010, ka urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin të vazhdojë hetimet për këtë procedim penal.

**28.** Nga praktika nr. \*\*\* e vitit 2018 rezulton se shtetasja T. Dh. i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me një ankim kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2012 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Shtetasja T. Dh. ka parashtruar se në datën 19.12.2012 është marrë vendimi për mosfillimin e procedimit penal nga prokurori Shpëtim Garunja, në çështjen penale nr. \*\*\* të vitit 2012, për akuzën “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal. Kjo shtetase ka pretenduar se ky vendim është i padrejtë dhe i njëanshëm dhe ka kërkuar shfuqizimin e vendimit dhe dërgimin e çështjes një prokurori tjetër. Drejtoria e Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale të Veprave të Tjera dhe të Miturve, me vendimin e datës 12.2.2014, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjekti të rivlerësimit, duke urdhëruar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal.

**29.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2021, ka informuar se ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar kallëzimet penale nr.\*\*\*, datë 21.11.2014, nr. \*\*\*, datë 20.3.2018 dhe nr. \*\*\* e vitit 2020.

**30.** Rezulton se materiali kallëzues nr. \*\*\* është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të paraqitur nga shtetasi V. Ç., në ngarkim të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e e veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kallëzuesi ka pretenduar se subjekti ka pushuar kallëzimin penal që ka bërë ndaj disa punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dy juristëve të Sigurimeve Shoqërore, lidhur me faktin se kur ka marrë në sekretarinë e gjykatës kopjen e dosjes gjyqësore, ku ishte në cilësinë e paditësit, ka konstatuar se i ishin hequr disa dokumente që pretendonte se i kishte dorëzuar në gjykim. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e datës 1.12.2014, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk ka asnjë dyshim apo *indicie* lidhur me ekzistencën e ndonjë vepre penale.

**31.** Referuar akteve të kallëzimit penal nr. \*\*\* rezulton se shtetasi T. K., me banim në fshatin \*\*\*, Tiranë, i cili është marrë i pandehur dhe akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës me një kallëzim penal ndaj oficerit të policisë gjyqësore A. M. dhe prokurorit Shpëtim Garunja, të cilët ndjekin çështjen në ngarkim të tij në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pretenduar se prej tyre është kryer vepra penale “shpërdorim detyre, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pas verifikimeve të kryera në lidhje me këtë kallëzim penal, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se nuk rezulton që nga oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori i çështjes të jenë kryer veprime në mospërbushje të detyrës. Ky vendim mosfillimi është lënë në fuqi nga gjykata e rrethit gjyqësor dhe gjykata e apelit.

**32.** Referuar akteve të materialit kallëzues nr.\*\*\* rezulton se shtetasja A. C. ka paraqitur kallëzim penal kundër shtetasve Shpëtim Garunja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, B. H. dhe V. S., gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprën penale “shpërdorim detyre”, të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Kallëzuesja ka pretenduar se shtetasit e mësipërm me veprime abuzive kanë shpërdoruar detyrën në lidhje me veprimet hetimore dhe të gjykimit të dosjes penale nr. \*\*\*, që bën fjalë për veprën penale “mashtrim”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, ndaj bashkëshortit të saj V. Ç., i deklaruar fajtor me vendim të formës së prerë.

**33.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2021, informon se ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\* të vitit 2021, për të cilin është vendosur mosfillim i procedimit penal. Rezulton se shtetasja L. D. ka paraqitur kallëzim penal kundër prokurorit Shpëtim Garunja, gjyqtarës Sh. D. dhe oficerit të policisë gjyqësore A. B., për kryerjen e veprës penale “shpërdorim detyre”. Kallëzuesja ka pretenduar se prokurori Shpëtim Garunja ka paraqitur kërkesën për pushimin e çështjes penale nr. \*\*\* pa kryer veprimet e plota hetimore. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në vendimin e datës 9.11.2021, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

### **Hetimi i Komisionit**

**34.** Komisioni administroi: nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>128</sup> fashikujt e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2012 dhe procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2017; nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin<sup>129</sup> fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2009; nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>130</sup> materialet kallëzues nr. \*\*\* të vitit 2021 dhe nr. \*\*\* të vitit 2021; dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës materialet kallëzuese nr. \*\*\* të vitit 2020<sup>131</sup> dhe nr. \*\*\*, datë 21.11.2014<sup>132</sup>. Gjithashtu, shqyrtoi dosjen e kallëzimit penal nr. \*\*\*, datë 20.3.2018, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që është pjesë e dokumentacionit të vlerësimit profesional të përcjellë nga KLP-ja.

**35.** Gjetjet nga shqyrtimi i dosjeve penale dhe materialeve kallëzuese të administruara pasqyrohen si më poshtë:

**36.** *Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\* të vitit 2012 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë*, regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se:

*i) Subjekti e ka bazuar vendimin për mosfillimin e procedimit penal në aktekspertimin autoteknik të datës 10.10.2012, i cili ka këto mangësi: (a) është i mbështetur në thëniet e personit nën hetim për sa i përket dëmtimeve të konstatuara në pjesën e tavanit të autoveturës; (b) nuk ka sqaruar elementet teknike të konstatimeve që tregojnë se gërvishjet në dorezën e biçikletës dhe deformimi i diskut të biçikletës ka ardhur nga përplasja me autoveturën; (c) konkluzioni i*

<sup>128</sup>Shkresat nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022; nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2022; nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2022.

<sup>129</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2022.

<sup>130</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.4.2022.

<sup>131</sup>Shkresë nr. \*\*\*-k., datë 19.4.2022.

<sup>132</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022.

ekspertit se semaforët në vendin e ngjarjes nuk kanë qenë në gjendje pune në momentin e ngjarjes nuk është i mbështetur në informacionin e organeve shtetërore që administrojnë trafikun; (ç) lidhur me konstatimin se gjurmët e ndodhura në vendin e ngjarjes nuk janë “gjurmë frenimi” por “gjurmë stercimi”, nuk pasqyrohen shenjat teknike që e dallojnë një gjurmë frenimi nga një gjurmë stercimi; (d) në aktekspertim nuk tregohet shpejtësia që duhet të ketë pasur autovetura në momentin e stercimit.

ii) Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore, pasi: (a) nuk ka bërë këqyrjen e regjistrit të sallës operative të policisë për të verifikuar deklarin e personit nën hetim se ka njoftuar shërbimin e policisë për ngjarjen e ndodhur; (b) nuk është identifikuar dhe as pyetur me cilësinë e dëshmitarit punonjësi i policisë i mbërritur i pari në vendin e ngjarjes i cili sipas personit nën hetim i ka dhënë atij leje të largohet nga vendi i ngjarjes; (c) nuk është identifikuar dhe pyetur punonjësi i policisë rrugore, i cili sipas deklaramit të të hetuarit e ka shoqëruar nga spitali ushtarak për në vendin e ngjarjes; (ç) nuk është sekuestruar dokumentacioni i pranimit të viktimës në spital për të verifikuar se cili ka qenë personi që realisht e ka dorëzuar viktimën në spital.

**37.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>133</sup>, lidhur me konstatimet e pikës i), subjekti i rivlerësimit shpjegon se pavarësisht se në vendimin e Prokurorisë së Përgjithshme<sup>134</sup> pasqyrohet se vendimi për pushimin e çështjes mbështetet vetëm në aktekspertimin auto-teknik, fakti, sipas tij, është ndryshe pasi në vendim janë analizuar provat dhe faktet e paraqitura nga policia gjyqësore, si dhe veprimet hetimore të kryera nga kjo e fundit. Gjithashtu, sqaron se konkluzionet e aktekspertimit auto-teknik janë dhënë në mënyrë të qartë lidhur me rrethanat e aksidentit, shkeljet e kryera nga përdoruesit e rrugës dhe shkakun e aksidentit. Në vijim, subjekti shpjegon se gjetja e Prokurorisë së Përgjithshme se *konstatimi në aktin e ekspertimit se semaforët nuk kanë qenë në gjendje pune nuk mbështetet në informacionin e organeve shtetërore*, sqaron se është i vërtetë, por nga eksperti dhe shërbimet e policisë gjyqësore ky fakt është konstatuar në vendngjarje dhe është pasqyruar në procesverbalin e datës 8.10.2012. Në vijim, shpjegon se nga informacioni i administruar nga Bashkia Tiranë rezulton se në atë periudhë kohore ky institucion nuk disponon të dhëna lidhur me gjendjen e semaforëve pasi nuk ka ekzistuar qendra e kontrollit të trafikut. Ndërsa për konstatimet e tjera, shpjegon se këto konstatime janë dytësore dhe që nuk ndikojnë në konkluzionin e arritur nga eksperti lidhur me shkakun e aksidentit dhe shkeljet e kryera nga palët.

**38.** Lidhur me mangësitë e konstatuara në pikën ii) të rezultateve të hetimit, për moskryerjen e veprimeve hetimore, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime.

### **Analiza e Komisionit**

**39.** Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale, rezulton se në orën 18:30, datë 8.10.2012, pranë kryqëzimit të rrugës “\*\*\*” me rrugën “\*\*\*”, ka ndodhur një aksident automobilistik me pasojë dëmtimin e shtetasit G. Dh., i cili ka ndërruar jetë më pas në spital në datën 11.10.2012. Ky aksident ka ndodhur si rezultat i përplasjes mes autoveturës së drejtuar nga shtetasi R. Gj. dhe viktimës G. Dh., i cili lëvizte në rrugë me biçikletë, duke pasur të njëjtin drejtim lëvizjeje me

<sup>133</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

<sup>134</sup>Drejtorisë së Hetimit dhe Kontrollit të Ndjekjes Penale të Veprave të Tjera dhe të Miturve.

autoveturën. Sipas aktekspertimit auto-teknik në veprimet e drejtuesit të autoveturës nuk është konstatuar shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, kurse në veprimet e viktimës G. Dh. rezulton shkelja e nenit 152, pika 1, germa “a” e Kodit Rrugor dhe shkak kryesor i ndodhjes së aksidentit është manovra e kthimit të biçikletës majtas në shkelje të këtij neni. Në përfundim të verifikimeve të kryera, me vendimin e datës 19.11.2012, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal bazuar në aktekspertimin auto-teknik të datës 10.10.2012.

**40.** Kundër vendimit të mosfillimit ka bërë ankim pranë Prokurorisë së Përgjithshme bashkëshortja e viktimës, shtetasja T. Dh.. Prokuroria e Përgjithshme, me vendimin e datës 12.2.2014, ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit të datës 19.11.2012” të subjekti të rivlerësimit, duke urdhëruar Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, të parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, duke arsyetuar se në aktekspertim janë konstatuar mangësi<sup>135</sup> dhe policia gjyqësore ka kryer veprime sipërfaqësore<sup>136</sup>.

**41.** Pas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e datës 19.2.2014, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal. Më pas, në datën 24.2.2014 ka paraqitur dorëheqjen nga ndjekja e procedimit penal, e cila është pranuar nga Drejtuesi i Prokurorisë. Në vijim, ndjekja e procedimit penal është bërë nga prokurori N. T., i cili, pasi ka plotësuar mangësitë e konstatuara nga Prokuroria e Përgjithshme, ka pyetur punonjësën e policisë që ka arritur në vendin e ngjarjes<sup>137</sup> dhe ka vendosur kryerjen e një ekspertimi të ri auto-teknik. Në aktekspertimin e datës 5.9.2014, ekspertët auto-teknikë kanë arritur në përfundimin se shkak determinant i ardhjes së aksidentit ka qenë manovra e ndryshimit të lëvizjes nga ana e çiklistit, moszbatimi i sinjaleve për kthimin majtas nga ana e e tij, si dhe qarkullimi çiklistit pa u pajisur me sistem ndriçimi. Bazuar në këtë konkluzion, prokurori i çështjes, me vendimin e datës 20.12.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal.

**42.** Komisioni mori në analizë veprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit në çështjen në fjalë, pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vendimi i tij nuk është i mbështetur vetëm në aktekspertimin auto-teknik por edhe në aktet e tjera hetimore. Komisioni thekson se në rezultatet e hetimit

---

<sup>135</sup>(a) Eksperti është shprehur se dëmtimet me shtypje në tavanin e autoveturës janë dëmtime të vjetra dhe për këtë konkluzion bazohet tek deklaratimet e drejtuesit të autoveturës; (b) në ekspertim shprehen qëndrime të paqarta të tipit: “Mendohet se” për gërvishtjen në dorezën e biçikletës e cila “mendohet se” është shkaktuar nga kontakti me pasqyrën e autoveturës dhe nuk saktëson se nga cilat elemente faktike rrjedh ky konkluzion, qoftë edhe hipotetik. Po kështu, edhe rreth goditjes dhe shtrembërimit të diskut të biçikletës që “mendohet se” është shkaktuar nga rrëzimi në asfalt i viktimës, pa sqaruar cilat elemente teknike tregojnë se deformimi i diskut të biçikletës ka ardhur nga përplasja me asfaltin dhe jo nga përplasja me autoveturën; (c) ekspertimi konkludon se semaforët në vendin e ngjarjes nuk kanë qenë në gjendje pune në momentin e ngjarjes, edhe pse gjendja teknike e semaforit nuk ka qenë pjesë e ekspertizës së tij dhe as i është drejtuar një pyetje e tillë në vendimin për caktimin e ekspertimit; (ç) në ekspertim theksohet se gjurmët e ndodhura në vendin e ngjarjes nuk janë “gjurmë frenimi” por “gjurmë stercimi” gjatë kthimit të autoveturës në të majtë, pa treguar se cilat janë shenjat teknike që e dallojnë një gjurmë frenimi nga një gjurmë stercimi dhe sa është shpejtësia.

<sup>136</sup>Nuk janë sqaruar në mënyrë të gjithanshme dhe bindëse, si mekanizmi i ngjarjes ashtu edhe shkak i aksidentit. Nuk është bërë këqyrja e regjistrimit të sallës operative për të verifikuar deklaratimet e të hetuarit nëse ka njoftuar apo jo shërbimin e policisë për ngjarjen e ndodhur, nuk është hetuar me qëllim identifikimin dhe evidentimin e ndonjë dëshmitari të mundshëm okular që ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes, si dhe identifikimin e dëshmitarëve të mundshëm të cilët kanë objektet, aktivitetet apo banesat në anë të rrugës pranë vendit të ngjarjes dhe që kanë dijeni për ngjarjen. Nuk është identifikuar dhe as pyetur me cilësinë e dëshmitarit punonjësi i policisë i mbërritur i pari në vendin e ngjarjes, i cili, siç pretendon shtetasi R. Gj., i ka dhënë leje të largohet nga vendi i ngjarjes. Nuk është identifikuar dhe pyetur punonjësi i policisë rrugore, i cili sipas deklaratimit të të hetuarit, e ka shoqëruar nga Spitali Ushtarak për në vendin e ngjarjes. Nuk është sekuestruar dokumentacioni i pranimit të viktimës në spital për të verifikuar se cili ka qenë personi që realisht e ka dorëzuar viktimën në spital.

<sup>137</sup>Në procesverbalin e datës 11.12.2014 ka deklaruar që nuk i kujtohej kjo ngjarje.

administrativ ka konkluduar për mungesë të hetimeve në çështjen në fjalë dhe jo për problematika në arsyetimin e vendimit të pushimit të procedimit penal. Në vijim, arsyeton se subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me gjendjen teknike të semaforit në kryqëzimin e rrugës “\*\*\*”, për të cilin ka administruar informacionin nga Bashkia e Tiranës, ndërkohë që për konstatimet e tjera lidhur me mangësitë e aktekspertimit auto-teknik të pasqyruara në pikën i) dhe moskryerjen e veprimeve hetimore të pasqyruara në pikën ii) të rezultateve të hetimit nuk ka dhënë shpjegime.

**43. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kriter që parashikohet në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

**44. Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, datë 24.11.2009, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin,** të regjistruar për kryerjen e veprës penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe “drejtim të mjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi” të parashikuar nga nenet 290/1 dhe 291 të Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se:

*i) Subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për sqarimin e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, pasi: (a) aktekspertimi auto-teknik është sipërfaqësor për sa i përket mekanizmit të ngjarjes lidhur me dinamikën dhe kinematikën e aksidentit rrugor, trajektoret goditjes, shpejtësinë e lëvizjes së mjeteve para aksidentit etj.; (b) konkluzionet e ekspertit se drejtuesja e automjetit F. N. nuk ka kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nuk mbështetet mbi një analizë objektive të rrethanave të ngjarjes dhe provave të grumbulluara në vendin e ngjarjes; (c) në aktekspertimin auto-teknik nuk është analizuar sinjalistika vertikale dhe horizontale për segmentin rrugor.*

*ii) Konkluzioni i subjektit në vendimin e datës 24.11.2009, “Për pushimin e hetimeve”, se nuk ka ardhur pasoja e parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, nuk mbështetet në aktekspertimin mjeko-ligjor të administruar gjatë hetimeve paraprake.*

**45. Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>138</sup>,** subjekti i rivlerësimit shpjegon se oficeri i policisë gjyqësore ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore dhe subjekti, në cilësinë e prokurorit, i ka konstatuar të drejta dhe të sakta pyetjet e tij drejtuar ekspertit auto-teknik. Më pas shpjegon se eksperti ka dhënë përgjigje të plota pyetjeve të paraqitura, duke sqaruar rrethanat, mekanizmin e ngjarjes dhe shkeljet e kryera nga secili drejtues mjeti. Sipas tij, konkluzioni i ekspertit është i qartë lidhur me shkakun determinant të ardhjes së aksidentit. Lidhur me konstatimin e pikës së dytë, sqaron se në vendimin e pushimit është analizuar dhe sqaruar ana objektive e veprës penale, pikërisht fakti se midis shkeljes së kryer dhe pasojës mungon lidhja shkakësore, pasi pasoja ka ardhur si rezultat i shkeljeve të kryera nga vetë drejtuesi i mjetit. Gjithashtu, shpjegon se nuk është kryer riekspertimi mjeko-ligjor, pasi nga hetimi dhe aktekspertimi auto-teknik ka rezultuar se shkak i aksidentit kanë qenë shkeljet e kryera nga drejtuesi i mjetit dhe në këto kushte, edhe sikur të vërtetohej pasoja e “plagosjes së

---

<sup>138</sup> Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

rëndë”, fakti nuk përbënte veprë penale. Më pas, shpjegon se edhe pas riçeljes së hetimeve është arritur në përfundimin e pushimit të hetimeve.

### **Analiza e Komisionit**

**46.** Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se në datën 10.10.2009, në rrugën automobilistike Thumanë-Mamuras, si pasojë e përplasjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” të drejtuar nga shtetasja F. N. me ciklomotorin e drejtuar nga shtetasi B. H. ka mbetur i plagosur ky i fundit. Nga veprimet hetimore ka rezultuar se automjeti tip “Mercedes-Benz” me drejtues shtetasen F. N. udhëtonte në drejtimin Thumanë-Mamuras dhe afër banesës së shtetasit L. M. shtetasja kjo shtetase ka kthyer majtas me qëllim për t’u futur në banesën e shtetasit L. M., por në afërsi të portës së shtëpisë është përplasur me ciklomotorin të drejtuar nga shtetasi B. H. Sipas ekspertimit mjeko-ligjor shtetasi B. H. ka pësuar dëmtime të cilat i kanë shkaktuar si pasojë humbjen e aftësisë së përkohshme në punë mbi 9 (nëntë) ditë, por për të parë ecurinë e dëmtimeve duhej që ky shtetas të paraqitej pas tre muajsh në Institutin e Mjekësisë Ligjore për një ekzaminim të dytë. Sipas aktekspertimit auto-teknik shkaku i aksidentit është shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të ciklomotorit, shtetasi B. H. i cili ka humbur kontrollin e mjetit. Gjithashtu, ka rezultuar se ky shtetas nuk ka pasur leje drejtimi për ciklomotorin e drejtuar prej tij, megjithëse ky mjet plotësonte kushtet e parashikuara në Kodin Rrugor për t’u drejtuar me leje drejtimi, kurse nga ana e drejtueses së automjetit, shtetasen F. N., nuk ka shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor.

**47.** Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 24.11.2009, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të shtetasen F. N. dhe dërgimin në gjyq të çështjes për të pandehurin B. H. për veprën penale të “Drejtimin të mjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi”, parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.1.2010, ka vendosur: “Deklarimin fajtor të të pandehurit B. H. për kryerjen e veprës penale “Drejtim i mjeteve pa dëshmi apo në gjendje të dehur”, të parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal duke e dënuar përfundimisht me 2 muaj burg. Në fund të vendimit pasqyrohet shënimi se vendimi ka marrë formë të prerë në datë 8.2.2010 pa u ankimuar.

**48.** Shtetasi B. H. ka paraqitur ankim pranë Prokurorisë së Përgjithshme për shfuqizimin e vendimit të pushimit të hetimeve dhe rifillimin e hetimeve ndaj shtetasen F. N. Prokuroria e Përgjithshme<sup>139</sup>, me vendimin e datës 5.10.2010, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të pushimit të hetimeve, duke urdhëruar vazhdimin e mëtejshëm të hetimeve për këtë veprë penale me arsyetimin se aktekspertimi auto-teknik është i përciptë dhe mbështetet mbi të dhëna jo të verifikuara<sup>140</sup>. Më pas, arsyeton se për të përcaktuar në mënyrë të qartë ekzistencën ose jo të

<sup>139</sup>Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes.

<sup>140</sup>(a) Vendimi për kryerjen e ekspertimit auto-teknik është i përciptë në parashkrimin e pyetjeve të cilave duhet t’u përgjigjej eksperti dhe për pasojë aktekspertimi auto-teknik është sipërfaqësor dhe jo i qartë në konkluzionet e tij; (b) konkluzionet e ekspertëve se drejtuesja e automjetit F. N. nuk ka kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, mbështeten mbi të dhëna jo të verifikuara; (c) eksperti në nxjerrjen e këtij konkluzioni nuk mbështetet mbi një analizë objektive të rrethanave të ngjarjes dhe provave të grumbulluara në vendin e ngjarjes; (ç) në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, si dhe në aktin e ekspertimit nuk është përcaktuar se cila është sinjalistika vertikale dhe horizontale për segmentin rrugor në të cilin ka ndodhur aksidenti dhe si është respektuar nga dy drejtuesit e mjeteve, gjë e cila është e domosdoshme në përpilimin e aktekspertimit auto-teknik dhe përcaktimin e shkakut të aksidentit; (d) aktekspertimi nuk ka sqaruar se cila është dinamika dhe kinematika e aksidentit rrugor, trajektorët e mjeteve deri në pikën e goditjes dhe pas saj, shpejtësia e mjeteve në momentin e aksidentit, pika e goditjes së tyre, etj.; (dh) në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, si dhe në aktekspertim nuk është përcaktuar se cila është sinjalistika vertikale dhe horizontale për segmentin rrugor në të cilin ka ndodhur aksidenti dhe si është respektuar nga dy drejtuesit e mjeteve, gjë e cila është e domosdoshme në përpilimin e aktekspertimit auto-teknik dhe përcaktimin e shkakut të aksidentit.



veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, është e domosdoshme të kryhet riekspertim mjeko-ligjor për të përcaktuar shkallën e dëmtimeve dhe kategorinë e dëmtimeve të shkaktuara nga aksidenti shtetasit B. H., pasi në ankimin e tij, ky shtetas ka parashtruar se ka bërë disa ndërhyrje kirurgjikale dhe nuk ka arritur të rikuperohej plotësisht nga aksidenti, çka i vë në dyshim konkluzionet e dhëna në aktekspertimin mjeko-ligjor, sipas të cilit dëmtimet hyjnë në kategorinë e plagosjeve të lehta.

**49.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me konstatimet e rezultateve të hetimit, por ka dhënë sqarime të përgjithshme lidhur me pyetjet që i ka drejtuar oficeri i policisë gjyqësore ekspertit auto-teknik dhe përgjigjet që sipas tij ishin të sakta. Në këto kushte, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për sqarimin e anës objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 290<sup>141</sup> i Kodit Penal, pasi: (i) aktekspertimi auto-teknik është sipërfaqësor lidhur me sqarimin e mekanizmit të ngjarjes (dinamikën dhe kinematikën e aksidentit rrugor, trajektorët e goditjes, shpejtësinë e lëvizjes së mjeteve para aksidentit); (ii) konkluzioni i ekspertit se drejtuesja e automjetit F. N. nuk ka kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor nuk mbështetet mbi analizën objektive të rrethanave të ngjarjes dhe provave të grumbulluara në vendin e ngjarjes; (iii) në aktekspertim nuk është analizuar sinjalistika vertikale dhe horizontale për segmentin rrugor në të cilin ka ndodhur aksidenti dhe si është respektuar nga dy drejtuesit e mjeteve, gjë e cila është e domosdoshme në përcaktimin e shkakut të aksidentit.

**50.** Në vijim, Komisioni arsyeton se në aktekspertimin mjeko-ligjor pasqyrohet se dëmtimet e shtetasit B. H. hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë sjellë humbjen e aftësisë së përkohshme mbi 9 ditë, por për të parë ecurinë e dëmtimeve duhet që ky shtetas të paraqitet pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore pas tre muajve që të ekzaminohet. Si rrjedhim, vetëm pas kryerjes së një aktekspertimi të ri mjeko-ligjor do të përcaktohej pasoja që ka sjellë aksidenti i shkaktuar. Si pasojë, konkluzioni i subjektit se nuk ka ardhur pasoja e parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal nuk mbështetet në aktekspertimin mjeko-ligjor të administruar gjatë hetimeve paraprake.

**51. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere që parashikohen në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

**52.** Lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, datë 15.7.2019, për kryerjen e veprës penale “*mashttrim*”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, i regjistruar, për kryerjen e veprës penale “*mashttrim*”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektivit të rivlerësimit për konstatimin se *subjekti nuk ka kryer veprimet hetimore, si: (i) nuk ka kërkuar ballafaqimin e kallëzueses me shtetasen V. Xh., në kushtet kur deklaratimet e tyre janë të kundërta; (ii) nuk ka pyetur drejtuesit e \*\*\* lidhur me shkakun pse nuk veprohet me pronën e lënë në kolateral nga shtetasi Y. S. për shlyerjen e kredisë; (iii) nuk ka sqaruar gjendjen juridike të pronës së lënë kolateral nga shtetasi Y. S. për garantimin e kredisë; (iv) nuk ka marrë në*

---

<sup>141</sup>Kodi Penal, neni 290, parashikon se: “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet...”.

pyetje punonjës in e \*\*\*, shtetasin F. K., të cilit kredimarrësit i kishin lënë prokurë për administrimin dhe disponimin e pronës së lënë kolateral deri në shlyerjen e kredisë lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e tij për këtë pronë me qëllim shlyerjen e detyrimeve që rridhnin nga kredia; (v) nuk ka pyetur drejtuesit e \*\*\* lidhur me shkakun për të cilin nuk mund të lidhej marrëveshja e re për bashkimin e detyrimeve; (vi) nuk ka kërkuar ballafaqimin e kallëzueses me shtetasen L. Sh., me detyrë drejtoreshë e departamentit juridik të \*\*\*; (vii) nuk ka kërkuar ballafaqimin e kallëzueses me shtetasin G. M., me detyrë drejtor i departamentit të kredisë pranë \*\*\*; (viii) nuk ka marrë në pyetje specialistin e burimeve njerëzore në lidhje me pretendimin e kallëzues për mbajtjen procesverbalit datë 9.5.2019, për anulimin e marrëveshjes së re që u ishte ofruar shtetasve Y. dhe A. S..

**53.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>142</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore janë të plota dhe shteruese, pasi gjykata e ka vlerësuar të drejtë kërkesën për pushimin e kësaj çështjeje, duke paraqitur edhe vendimin nr. \*\*\* regj., datë 17.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale. Lidhur me moskryerjen e veprimeve hetimore, subjekti shpjegon se shtetasi F. K. nuk është pyetur nga policia gjyqësore pasi ka rezultuar se nga verifikimi i sistemit TIMS ky shtetas ishte larguar jashtë vendit në datën 13.3.2020 nga pika kufitare e Aeroportit të Rinasit në linjën Tiranë-Stamboll dhe nuk ka hyrë në vendin tonë. Lidhur me moskryerjen e ballafaqimit, shpjegon se ky veprim është shumë formal në raport me provat e tjera dhe nuk do të sillte rezultat të ndryshëm.

**54.** Më pas, subjekti shpjegon se ky ishte një rast që përbënte “gjë të gjykuar”, pasi ndaj shtetasve A. dhe Y. S. ishte regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, në bazë të kallëzimit penal të \*\*\*, për kryerjen e veprës penale “mashttrim në kredi”, ku në përfundim të hetimit prokurori i çështjes i është drejtuar gjykatës për pushimin e procedimit penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 25.9.2019, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal. Ky vendim, sipas subjektit, ka marrë formë të prerë në datën 21.11.2019 dhe, për rrjedhojë, përbën “gjë të gjykuar”. Në vijim, subjekti shpjegon se ka administruar fashikullin e këtij procedimi penal dhe ka rezultuar se është pyetur shtetasi F. K. dhe drejtuesit e \*\*\*.

### **Analiza e Komisionit**

**55.** Nga shqyrtimi i akteve të dosjes penale rezulton se shtetasja L. D. ka paraqitur kallëzim penal ndaj disa drejtuesve të lartë të \*\*\* për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, pasi në kundërshtim me detyrën dhe me rregullat kanë ndërhyrë në pagën e saj duke bërë ndalesa, pa vendim gjykate dhe pa autorizimin e saj. Sipas kallëzueses ndalimet e pagës janë bërë për shkak të një kredie të marrë nga shtetasi Y. dhe A. S. nga \*\*\*, ku ajo si oficerë kredie dhe punonjëse e fondit është urdhëruar dhe ka firmosur si garante e shlyerjes së kredisë. Rezulton se ndërmjet \*\*\* dhe shtetasve A. S., në cilësinë e kredimarrëses, dhe shtetasve Y. S. dhe L. D., në cilësinë e dorëzanësve, është lidhur kontrata e kredisë dhe hipotekës e datës 19.3.2016, me objekt “dhënien e një kredie në shumën 700.000 lekë”, për një periudhë 48 muaj. Për garantimin e shlyerjes së kredisë ndërmjet \*\*\* dhe shtetasit

<sup>142</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

Y. S. është lidhur kontrata premtim hipotekimi (pasuri e paluajtshme) nr. \*\*\*, pa datë, në të cilën parashikohet se palët kanë rënë dakord për lidhjen e kontratës së kredisë dhe si pasuri e propozuar për t'u bllokuar në emër të \*\*\* është pasuria "Pronë truall me sipërfaqe 324 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën: blloku \*\*\*, parcela \*\*\*, në hyrje të qytetit të Sarandës, pranë rrugës së re". Gjithashtu, kanë përcaktuar se: "...Y. S.... angazhohet dhe garanton që me marrjen e pronësisë mbi 'pronë truall', me sipërfaqe 324 m<sup>2</sup>, e ndodhur në adresën: blloku \*\*\*, parcela \*\*\*, në hyrje të qytetit të Sarandës, pranë rrugës së re objekt i kontratës së sipërmarrjes të noterizuar me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2004, do të bllokojë pasuritë në emër të \*\*\* sh.a. si garanci hipotekore për kredisë e marrë nga znj. A. S.". Në kushtet kur prona nuk ishte e regjistruar, kredimarrësit kanë lëshuar një prokurë punonjësit të \*\*\* në Sarandë, shtetasit F. K., për të ndjekur hapat që prona e lënë kolateral të bëhej e vlefshme dhe me të të shlyheshin detyrimet.

**56.** Kur shtetasit Y. dhe A. S. kanë deklaruar se nuk kishin mundësi të paguanin këstet e kredisë nga ai moment kallëzuesja ka filluar të shlyejë detyrimet e tyre deri në sqarimin e situatës së pronës të lënë kolateral. Kallëzuesja ka pretenduar se pavarësisht se ndërmjet \*\*\* dhe shtetasit Y. S. është nënshkruar kontrata premtim hipotekimi duke vendosur si kolateral truallin me sip. 324 m<sup>2</sup>, për garantimin e shlyerjes së kredisë, nga drejtuesit e \*\*\* nuk vepron mbi kolateralin objekt hipoteke, por kanë mbajtur nga paga e saj këstet e kredisë dhe se me veprime e mosveprime të qëllimshme kanë penguar dhe kanë refuzuar çdo rrugë për t'i dhënë zgjidhje situatës.

**57.** Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga gjykata pushimin e çështjes penale, me arsyetimin se ndalesat e kryera nga përfaqësuesit e \*\*\* në pagën e kallëzueses janë bërë për shkak të parashikimeve në kontratën e kredisë të lidhur përpara noterit publik me vullnetin e lirë të palëve dhe për shkak të profesionit e përvojës së saj si oficerë kredie kallëzuesja ka pasur dijeni për sanksionet që merren në rast të mospërmbushjes së detyrimeve. Më tej, subjekti arsyeton se konflikti i lindur ndërmjet palëve është një konflikt juridiko-civil, i cili mund të zgjidhet me mirëkuptim ose me kërkesëpadi në gjykatë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj. them., datë 14.9.2020, ka vendosur kthimin e akteve të prokurorisë dhe detyrimin për vazhdimin e hetimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 90 ditëve, duke parashikuar dhe veprime hetimore që duhen kryer<sup>143</sup>. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 1.3.2021.

**58.** Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm vetëm faktin e mosmarrjes në pyetje të shtetasit F. K., për shkak se ishte larguar jashtë vendit, ndërsa për konstatimet e tjera nuk ka dhënë shpjegime bindëse. Sqarimi i tij se veprimet e kryera nga oficeri i policisë gjyqësore janë të plota dhe shteruese, pasi gjykata e ka vlerësuar të drejtë kërkesën për pushimin e kësaj çështjeje duke paraqitur edhe vendimin nr. \*\*\* regj., datë

---

<sup>143</sup>Të pyetet shtetasja E. Q., me detyrë drejtore e Departamentit të Burimeve Njerëzore, në lidhje me arsyetimin e ndalimit të pagës shtetas L. D.; të bëhet ballafaqim mes kallëzueses L. D. dhe shtetas V. Xh., me detyrë drejtore e Degës Rajonale Tirana \*\*\*; të bëhet ballafaqimi mes kallëzues L. D. dhe shtetas L. Sh., me detyrë drejtore e Departamentit Juridik; të bëhet ballafaqim mes kallëzueses L. D. dhe shtetasit G. M., me detyrë drejtor i Departamentit të Kredisë; të pyetet me cilësinë e deklaruës P. Ç., me detyrë specialist i burimeve njerëzore të \*\*\*, në lidhje me pretendimin e kallëzues për mbajtjen e procesverbalit datë 9.5.2019, për anulimin e marrëveshjes që u ishte ofruar klientëve Y. dhe A. S.; të pyetet me cilësinë e deklaruës F. K., punonjës i \*\*\*, dega Sarandë, në lidhje me veprimet e bëra nga ana e tij në zbatim të prokurës së dhënë nga kredimarrësit A. dhe Y. S.; prokuroria të hetojë nëse ka elemente të veprës penale "shpërdorim detyrë" apo elemente të ndonjë veprë tjetër penale.

17.3.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes penale, nuk qëndron, pasi gjykata në vendimin e datës 17.3.2022 i ka konstatuar të plota veprimet hetimore, pasi prokuroria ka plotësuar detyrat e lëna nga gjykata në vendimin e datës 14.9.2020.

**59.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kjo çështje ishte një rast që përbënte “gjë të gjykuar”, pasi ndaj shtetasve A. dhe Y. S. ishte regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* në bazë të kallëzimit penal të \*\*\* për kryerjen e veprës penale “mashttrim në kredi” dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 25.9.2019, ka pranuar kërkesën e prokurorit dhe ka vendosur pushimin e procedimit penal. Komisioni arsyeton se ky pretendim nuk mbështetet në nenin 7<sup>144</sup> të Kodit të Procedurës Penale, pasi nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. \*\*\*<sup>145</sup> dhe vendimit nr. \*\*\* regj. them., 25.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se palë në këtë proces gjyqësor kanë qenë shtetasit A. dhe Y. S., ndaj të cilëve \*\*\* ka paraqitur kallëzim për kryerjen e veprës penale “mashttrim në kredi”, të parashikuar nga neni 146 i Kodit Penal, ndërsa në çështjen konkrete kallëzimi penal është bërë nga shtetasja L. D. kundër punonjësve të \*\*\* për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal.

**60.** Në vijim të arsytimit të mësipërm, Komisioni arsyeton se nëse subjekti do të kishte administruar aktet e procedimit penal nr. \*\*\* dhe vendimin nr. \*\*\* regj. them., datë 25.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>146</sup>, në të cilin është provuar që dokumentacioni i pronësisë i paraqitur nga shtetasi për Y. S. për marrjen e kredisë është i vërtetë, atëherë hetimi i tij do të drejtohej drejt zbulimit të faktit se përse punonjësit e \*\*\* nuk vepronin mbi pronën e lënë në hipotekë nga shtetasi Y. S. duke i dhënë përgjigje pretendimeve të kallëzueses.

**61. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj dhe për të interpretuar ligjin, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

## DENONCIME

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja, janë administruar 7 denoncime nga publiku. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime për 3 denoncime, si më poshtë vijon:

**62. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018, të shtetasës M. M.,** e cila akuzon subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja se ka dhënë vendim të padrejtë kundrejt saj, duke vendosur mosfillimin e procedimit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se *subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për vërtetimin e pretendimeve të kallëzueses për falsifikimin e mandateve të tërheqjes së parave nga “Raiffeisen Bank”; subjekti ka marrë vendimin për “Mosfillimin e procedimit penal”, me arsyetimin se*

---

<sup>144</sup>Kodi i Procedurës Penale, neni 7, parashikon se: “Askush nuk mund të gjykohet rishtas për të njëjtën vepër penale, për të cilën është gjykuar me vendim të formë së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente”.

<sup>145</sup>Pjesë e dosjes penale nr. \*\*\*, datë 15.7.2019.

<sup>146</sup>Akte të cilat janë administruar pas dhënies së vendimit gjyqësor të datës 14.9.2020.

*“ndjekja penale për këto vepra penale është parashkruar”, si pasojë e moskryerjes së veprimeve hetimore për verifikimin e nënshkrimeve në mandatet bankare.*

**63.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>147</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se policia gjyqësore ka thirrur dhe pyetur kallëzuesen në cilësinë e personit që tregon rrethanat e hetimit dhe kur është pyetur se çfarë mund të thoshte për faktin se dy faturat e bankës janë në emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e saj dhe nëse këto dokumente janë firmosur nga ana e saj, sipas subjektit të rivlerësimit, kallëzuesja ka pohuar se të dyja faturat i ka parë dhe pranon faktin se është emri, mbiemri dhe firma e saj, por ato janë hedhur shabllon sepse nuk i ka tërhequr paratë që i janë dhënë si shpërblim. Gjithashtu, shpjegon se nga Policia e Shtetit, ashtu edhe nga kallëzuesja, nuk është paraqitur ndonjë fakt ose e dhënë konkrete që bazuar në prova të krijohej dyshimi i arsyeshëm se ndonjë nga dokumentet që përmenden në këtë rast të jetë falsifikuar. Më pas shpjegon se vendimi është kontrolluar nga zv. Drejtuesi i Prokurorisë dhe se ndaj vendimit kallëzuesja nuk ka bërë ankim.

### **Analiza e Komisionit**

**64.** Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit të datës 22.7.2016, për mosfillimin e procedimit penal, rezulton se në datën 20.6.2016 shtetasja M. M. është paraqitur pranë Komisarariatit të Policisë nr. \*\*\* dhe ka pretenduar se në tetor të vitit 2015 “Raiffeisen Bank” e ka telefonuar dhe i ka thënë se ishte debitore në shumën 37.740,97 lekë. Kjo shtetase ka vajtur në zyrën e pritjes se kësaj banke, ku e kanë njoftuar që ishte debitore në shumën e sipërcituar. Nga shkresat që i ka dhënë banka mori dijëni se puna ku kishte qenë mësuese i kishte hedhur që në atë kohë shpërblimin e pensionit prej 2 rroga e gjysmë, por nuk ishte njoftuar nga banka. Ajo ka sqaruar se në korrik të vitit 2006 ka dalë në pension dhe se paratë e këtij shpërblimi pensioni nuk i ka tërhequr. “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2016, i ka bërë me dije kallëzueses se tërheqjet e kryera nga llogaria e saj në datën 4.7.2006 për vlerën 13.900 lekë dhe në datën 15.8.2006 për vlerën 56.800 lekë, janë kryer nga vetë ajo, duke i dërguar kopje të mandateve të tërheqjes. Kallëzuesja është pyetur nga policia gjyqësore për faktin, ku pasi njihet me mandatet e tërheqjes pranon se është emri, mbiemri dhe firma e saj, por pretendon se ato janë të hedhura shabllon dhe nuk janë firmosur prej saj sepse nuk i ka tërhequr.

**65.** Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit, në shpjegimin e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit, shpjegon se kallëzuesja pranon faktin se në mandatet bankare të tërheqjes është emri, mbiemri dhe firma e saj, por ato janë hedhur shabllon sepse nuk i ka tërhequr paratë që i janë dhënë si shpërblim, shpjegim ky nuk që është i njëjtë me përmbajtjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, pasi në të, përveç citimit të mësipërm, pasqyrohet se kallëzuesja është shprehur se nuk janë të firmosura nga ana e saj. Në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, subjekti duhet të kryente aktekspertimin grafik për të verifikuar nëse nënshkrimi i mandateve bankare të tërheqjes së parave ishte ose jo i kallëzueses. Referuar përmbajtjes së vendimit për mosfillimin e procedimit penal dhe shpjegimeve në përgjigje të rezultateve të hetimit, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të këtë urdhëruar kryerjen e aktekspertimit grafik, por në vendimin e mosfillimit të procedimit penal arsyeton se nga verifikimi dhe këqyrja me sy të lirë e shkrimeve dhe nënshkrimeve në emër të kallëzueses rezultojnë të njëjta me

---

<sup>147</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

shkrimin dhe nënshkrimin e shtetases M. M., duke vepruar në kundërshtim me nenin 178 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore. Si pasojë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

**66. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore dhe për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, kritere të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

**67. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2019, të shtetases Z. T.,** e cila akuzon subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja se ka devijuar nga kërkesa e saj për të cilësuar si të pandehur dhe bashkëshorten e personit që e ka mashtruar, Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit shpjegime për konstatimin se *subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për vërtetimin e pretendimeve të kallëzuesit për bashkëpunimin e bashkëshortes së të pandehurit në kryerjen e veprës penale, pasi: (i) nuk ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit për të vërtetuar pretendimin e kallëzuesit se deklarata është shkruar nga bashkëshortja e të pandehurit; (ii) nuk ka hetuar lidhur me rolin që ka pasur bashkëshortja e të pandehurit në kryerjen e veprës penale; (iii) nuk ka hetuar nëse bashkëshortja e të pandehurit ka konsumuar elementet ligjore të bashkëpunimit të parashikuar në nenet 25 e 26 të Kodit Penal.*

**68.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>148</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se kjo çështje i është nënshtruar kontrollit dhe shqyrtimit gjyqësor dhe rezulton se në përfundim të gjykimit paraprak Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 27.3.2018, nuk ka gjetur shkelje ligjore dhe nuk ka konstatuar nevojën për ngritjen e ndonjë akuze për personat e tjerë, si dhe ka vlerësuar se ka prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, duke vendosur dërgimin çështjes në gjyq. Më pas, shpjegon se gjatë hetimeve dhe në gjykim nuk rezultoi asnjë *indicie*, provë a fakt konkret që shtetasja A. C. të ketë kërkuar ose marrë nga viktimat qoftë edhe një sasi minimale të hollash. Sipas subjektit të rivlerësimit, fakti që kjo shtetase është bashkëshortja e të pandehurit dhe ka dijeni për marrëdhënien e bashkëshortit të saj me viktimat lidhur me shumat e marra nga i pandehuri, është bashkortake me të pandehurin në biznes, është personi që ka marrë kontakt me viktimën S. T. pas largimit dhe fshehjes së të pandehurit, si dhe se është personi që mbi bazën e deklaramit të viktimës i ka lëshuar një deklaratë që njeh detyrimet për një shumë të caktuar, nuk përbën shkak për cilësimin e saj si bashkëpunëtoresh në kryerjen e veprës penale, në kuptim të nenit 25 të Kodit Penal dhe as autore të kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 14 i Kodit Penal ose ndonjë veprë tjetër penale.

### **Analiza e Komisionit**

**69.** Nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. \*\*\* rezulton se në datën 3.7.2017, janë paraqitur në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe kanë dhënë kallëzim penal shtetasit S. D., P. C., L. K. dhe S. T., të cilët kanë kallëzuar se shtetasi V. C. i ka marrë dhe vjedhur me anë të mashtrimit shuma të mëdha të hollash, me pretendime të ndryshme dhe nuk i ka kthyer, duke u fshehur dhe larguar në drejtim të paditur. Shtetasi S. T., në procesverbalin e mbajtur

---

<sup>148</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

nga oficeri i policisë gjyqësore, ka deklaruar se ka takuar bashkëshorten e shtetasit V. C., A., e cila i ka premtuar se do t'i marrë paratë, si dhe i ka lëshuar një deklaratë dore që e shkroi në emër të shtetasit V. C., ku ky i fundit pranon se i ka marrë hua z. S. T. shumën 100.000 euro. Gjithashtu, ka sqaruar se bashkëshortja e shtetasit V. C. vendosi firmën në emrin e tij dhe vulën e kompanisë së tij të karburantit. Kjo deklaratë me shkrim dore është pjesë e dosjes penale. Me vendimin e datës 28.2.2018, subjekti i rivlerësimit ka vendosur marrjen si të pandehur shtetasin V. C. për veprën penale “mashttrim”, të kryer në dëm të disa personave dhe me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/2, 3 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\* regj., datë 27.3.2018, vendosi dërgimin për gjykim të çështjes penale dhe më pas, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.10.2018, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit V. C. për kryerjen e veprës penale “mashttrim”, të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal, duke e dënuar përfundimisht me 6 vjet burgim.

**70.** Për sa i përket shpjegimit të subjektit të rivlerësimit se gjykata në vendimin nr. \*\*\* (seancës paraprake) nuk ka gjetur shkelje ligjore dhe nuk ka konstatuar nevojën për ngritjen e ndonjë akuze për personat e tjerë dhe ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq, Komisioni arsyeton se në rastin konkret nuk ka shqyrtuar çështjen penale me qëllim për t'i dhënë zgjidhje me pasoja konkrete për palët, por ka analizuar qëndrimin dhe sjelljen profesionale të subjektit të rivlerësimit. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit<sup>149</sup>, të njëjtat rrethana dhe fakte mund të jenë objekt i procedimeve të ndryshme si penale, civile apo administrative.

**71.** Në rastin konkret rezulton se kallëzuesi S. T. ka pretenduar se shtetasja A. C. ka dijeni për marrjen e parave dhe i ka dorëzuar një deklaratë dore të shkruar prej saj, duke deklaruar dhe firmosur në emër të bashkëshortit V. C., ku pranon marrjen e huas në shumën 100.000 euro. Ndërsa në procesverbalin e datës 5.10.2017, të mbajtur nga oficeri i policisë gjyqësore, lidhur me deklaratimet e shtetasës A. C., e cila, lidhur me pyetjen nëse V. (bashkëshorti i saj) ka marrë shuma të konsiderueshme nga shtetasi S. T., është përgjigjur se: “Unë nuk di asgjë se çfarë ka bërë S. me V.. Nuk kam parë asgjë”. Në vijim të ndjekjes logjike të hetimit, Komisioni arsyeton se subjekti i rivlerësimit duhet të urdhëronte kryerjen e aktekspertimit grafik për të vërtetuar faktin nëse deklarata është shkruar ose jo nga kjo shtetase. Vërtetimi i këtij fakti, së bashku me rrethanat e tjera të përmendura nga vetë subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij<sup>150</sup>, janë *indicie* që hetimi të drejtohej rreth rolit që kjo shtetase ka pasur në kryerjen e veprës penale dhe nëse prej saj janë konsumuar elementet e bashkëpunimit të parashikuar në nenet 25 e 26 të Kodit Penal.

**72. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, kriter i parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

---

<sup>149</sup>Vendimi nr. 30, datë 18.11.2019 (f. 52).

<sup>150</sup>Shtetasja A. C. është bashkëshortja e të pandehurit dhe ka dijeni për marrëdhënien e bashkëshortit të saj me viktimat lidhur me shumën e marra prej tij, është bashkëshortja me të pandehurin në biznes, është personi që ka marrë kontakt me viktimën S. T., pas largimit dhe fshehjes së të pandehurit, si dhe është personi që mbi bazën e deklaratimit të viktimës i ka lëshuar një deklaratë që njeh detyrimet për një shumë të caktuar.

**73. Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2020, të shtetas F. L.,** e cila akuzon subjektin e rivlerësimit Shpëtim Garunja për mos hetim të kallëzimit, Komisioni i kërkoi subjektin të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se *subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore për vërtetimin e pretendimeve të kallëzueses për paraqitjen e dokumenteve të falsifikuara nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.*

**74.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>151</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga kallëzuesja Sh. L. dhe nga denoncuesja F. L. nuk është paraqitur asnjë dokument, provë a fakt konkret që të krijojë dyshime të arsyeshme dhe të përbëjë të dhëna të mjaftueshme në kuptim të ligjit penal dhe procedural penal se është falsifikuar ndonjë dokument. Sipas tij çështja konkrete është juridiko-civile që duhet zgjidhur me mirëkuptim ose me padi civile në gjykatë.

### **Analiza e Komisionit**

**75.** Nga shqyrtimi i dosjes së kallëzimit penal nr. \*\*\* të vitit 2020 rezulton se në datën 21.1.2020 shtetasja Sh. L. është paraqitur në Komisarriatin e Policisë nr. \*\*\* Tiranë dhe ka bërë kallëzim ndaj shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k. Kallëzuesja ka pretenduar se ngjitur me pronën e familjes së saj shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. ka ndërtuar një pallat dhe në përfundim të tij punëtorët e shoqërisë kanë hequr rrethimin dhe kanë pastruar ambientin, për të cilin kallëzuesja pretendon se është pronë e saj, me qëllim për të siguruar rrugëkalimin për të hyrë në parkimin e pallatit. Kallëzuesja ka pretenduar se kur është bërë projekti dhe ndërtimi nuk e kanë njohur si pronare të truallit, nuk janë respektuar distancat e pronave, nuk është mbajtur kallkani dhe nuk u kanë marrë deklaratat materiale si kufitare nëse ishin dakord me këtë ndërtim. Gjithashtu, pretendon se ky ndërtim është bërë me dokumente të falsifikuara dhe kjo duket tek vërtetimi që kjo firmë ka marrë nga hipoteka që pjesën e saj e ka quajtur pronar i pavërtetuar dhe një pjesë pronar shtet. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 10.2.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se konflikti i kallëzueses me subjektin ndërtues “\*\*\*” sh.p.k. për cenimin e pronës, prishjen e murit, mosrespektim i distancave të pronave etj., janë konflikte juridiko-civile që duhen zgjidhur me mirëkuptim ose me padi civile në gjykatën kompetente.

**76.** Komisioni konstaton se kallëzuesja ka paraqitur si prova materiale dokumentet e pronësisë<sup>152</sup> që disponon. Gjithashtu edhe drejtoresha juridike e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. ka vënë në dispozicion të organit procedues dokumentacionin përkatës që disponon shoqëria<sup>153</sup>. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga kallëzuesja rezulton se sipas dokumentit “Vërtetim nga dokument hipotekor”, i datës 22.6.2000 dhe printimit të të dhënave të pasurisë nga sistemi i elektronik i ZVRPP-së Tiranë, familja L. figuron pronare e pasurive “truall me sip. 1.200 m<sup>2</sup>, një shtëpi banimi me 3 dhoma dhe një godinë 4-katëshe me sip. 362 m<sup>2</sup>, një truall i zënë me rrugë, një truall i zënë më dyqan vajguri, një truall i zënë me garazh, me sip. 49 m<sup>2</sup>, një truall i zënë me kioskë me sip. 13 m<sup>2</sup> dhe dy troje të lira, përkatësisht 280 m<sup>2</sup> dhe 320 m<sup>2</sup>”, ndërsa

<sup>151</sup>Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ të subjektin të rivlerësimit Shpëtim Garunja, datë 18.7.2022 (nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2022, në Komision).

<sup>152</sup>Fotokopje e vërtetimit hipotekor, datë 22.6.2000; vendim nr. \*\*\*, datë 1.7.1998, i KRRT Bashkia Tiranë; formulari 4, leje ndërtimi datë 18.5.2000; kopje të dokumentit “Të dhënat e pasurisë”, të ZVRPP-së Tiranë.

<sup>153</sup>Fotokopje e certifikatës së pronësisë së familjes H.; fotokopje e certifikatës së pronësisë së familjes R.; fotokopje e pasurisë shtet nr. \*\*\* e llojit shesh; fotokopje e lejes së ndërtimit nr. \*\*\* datë 11.6.2018; fotokopje e vendimit të miratimit të lejes së ndërtimit nr. \*\*\*; fotokopje e planit të detajuar vendor; fotokopje e planvendosjes së lejes së ndërtimit.



sipas dokumentacionit të paraqitur nga përfaqësuesja e shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.<sup>154</sup> rezulton se trualli i pretenduar nga kallëzuesja si pronë e saj figuron në pronësi shtet.

**77.** Komisioni arsyeton se në vijim të ndjekjes logjike të hetimit subjekti i rivlerësimit duhet të kryente veprimet hetimore për të verifikuar shkakun e mospërputhjes së përmbajtjes së dokumenteve të paraqitura nga palët për të njëjtin truall, si dhe të administronte nga Bashkia Tiranë dokumentacionin e pronësisë të paraqitur nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k. për marrjen e lejes së ndërtimit. Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk i ka kryer këto veprime hetimore. Në vijim të arsytimit, Komisioni çmon se vetëm pas kryerjes së veprimeve hetimore të mësipërme subjekti i rivlerësimit mund të arrinte në përfundimin se në rastin konkret nuk janë konsumuar elementet e figurës së ndonjë vepre penale.

**78. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore bazuar në treguesin e aftësisë së përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, kriteri i parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

### **Përfundimet e Komisionit në lidhje me rivlerësimin e aftësive profesionale**

**79.** Pavarësisht sa më sipër, në raport me të gjitha çështjet e analizuara, Komisioni, duke marrë në konsideratë numrin e çështjeve penale të analizuara në raport me çështjeve penale të ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016 (978 çështje), faktin se nuk konstatohen raste të gjykimeve me gabime thelbësore dhe serioze, bazuar edhe në parimin e proporcionalitetit, vlerëson se konstatimet e pasqyruara në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”.

**Në përfundim,** trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Shpëtim Garunja, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, germën “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

<sup>154</sup>Kartela e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, Tiranë.

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Garunja, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 26.7.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Pamela QIRKO**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*